



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

OKR
Qendra Kombëtare e Regjistrimit
National Registration Center

NUMRI SERIAL:
SN-240814-06-14

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

Personit të tatueshëm:

A.L.T.E.A. & GEOSTUDIO 2000 – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar

Statusi:

Aktiv

Me adresë kryesore:

Tirane, Vore, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 12, Picar Vorë, Ndërtesë tre kate me numër Pronësie 495978 dhe me numër Pasurie 40/57

I jepet ky numër identifikimi (NUIS):

J62026003M

Afati i veprimtarisë:

Nga: 08/08/1994 deri

DATA E REGJISTRIMIT
20/08/1996

DATA E LËSHIMIT
27-06-2014

SPORTELI I SHËRBIMIT:

QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

BLERINA BASHKEXHA
(Emri, Mbiemri) i nëpunësit të spontelit të tatueshëm.

Kjo certifikatë është nën kontroll të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshime të cilin do të raportojë detajli ose ndërpritet detyrimi ligjor për të qenë i tatueshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrje e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit

L I C E N C Ë
GJ.0014/4



MBIEMRI	ALLKJA
EMRI	SKËNDER
ATËSIA	XHAFER
DATËLINDJA	02.01.1955, Librazhd
VENDBANIMI	TIRANË
DIPLOMUAR, MË	1979
TITULLI	Ing. Gjeolog
Regjistruar në Regjistrin profesional që nga data :	24.07.2017



NË PROJEKTIM

Kat.	9	a	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trullit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.
		b	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trullit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate.
		c	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trullit për objekte të mëdha H/Ç, porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.
		d	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
		e	Studime e projekte hidrogjeologjike.

KRYETARI I KOMISIONIT

GERTA LUBONJA

KATEGORITË NË FUSHAT E STUDIMIT DHE PROJEKTIMIT NË NDËRTIM

1	PROJEKTIM URBANIST	7	PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI
a	1. Plane kombëtare sektoriale; 2. Plane të detajuara për zona të rëndësishme kombëtare. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).	a	Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.
b	1. Plane sektoriale në nivel qarku; 2. Plane sektoriale në nivel bashkie. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridikë (shoqëri/studio).	b	Ura dhe vepra arti mbi 10 m.
c	Plane të detajuara vendore.	c	Ura/viadukte me hapësira të mëdha drite, ura të varura, ura me sisteme të pacaktuara statikisht dhe sisteme të tjera speciale.
2	PROJEKTIM ARKITEKT	d	Ura metalike.
a	Projektim arkitekturor për objekte banimi – objekte industriale – objekte turistike.	e	Tunele rrugore - hekurudhore.
b	1. Objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara; 2. Qendra tregtare; objekte social-kulturore; objekte kulli; objekte arsimore; 3. Objekte spitalore; terminalët në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.	8	PROJEKTUES GJEODET
c	Projektim interiere.	a	Rilevime inxhinierike.
d	Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.	b	Rilevime inxhinierike kadastrale.
3	PROJEKTUES KONSTRUKTOR	c	Sisteme GIS.
a	Objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.	d	Bazamente gjeodezike.
b	1. Objekte civile – industriale – turistike mbi 5 kate – 2. objekte me skelet metalik.	e	Projektim fotogrametrik dhe hartografik.
c	1. Objekte me shkallë të lartë vështrësie Beton-arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.	9	STUDIM GJEOLGJIK INXHINIERIK – HIDROGJEOLGJIK
d	Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.	a	Studim/Vlerësim gjeologjiko-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.
e	Objekte civile e turistike prej druri.	b	Studim/Vlerësim gjeologjiko-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate.
4	PROJEKTUES INSTALATOR	c	Studim/Vlerësim gjeologjiko-inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/C, porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.
a	Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.	d	Studim/Vlerësim gjeologjiko-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
b	Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.	e	Studime e projektme hidrogeologjike.
c	Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.	10	PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
d	Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit.	a	Centrale hidraulike (elektrike, primare, sekondare). Kjo kategori jepet vetëm për persona juridikë (shoqëri/studio).
e	Projektim të sistemeve të furnizimit me gaz.	b	Centrale termike (primare, sekondare). Kjo kategori jepet vetëm për persona juridikë (shoqëri/studio).
f	Projektim të sistemeve kundra zjarrit.	c	Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era, etj.
g	Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.	d	Nënstacione elektrike, primare sekondare – linja të tensionit të lartë.
h	Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, etj.)	e	Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.
i	Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.	11	PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR
j	Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access Controlit, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale.	a	Sinjalistikë jonëdrifues në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.
5	PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE	b	Sinjalistikë jonëdrifues në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhë.
a	Diga të mëdha (diga me lartësi mbi 10 m ose me vëllim uji të grumbulluar mbi 1 milion m ³ ose gjatësi kurore dige mbi 500 m).	c	Sinjalistikë jonëdrifues në aeroporte dhe heliporte.
b	Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.	d	Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.
c	Ujësjetës kanalizime urbane – rurale.	12	STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/studio)
d	Vepra ujëje – kullimi – impiante vaditëse – diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) – damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.	a	Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.
e	Vepra të trajtimit të ujit. Kjo kategori jepet vetëm për personat juridikë (shoqëri/studio).	b	Studime/vlerësime gjeologjiko-sizmike për troje ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.
f	Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi – shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.	c	Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte, etj.
g	Vepra naftësjetës – gazsjellës – vajsjetës etj.	d	Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje ku ndërtohen objekte komplekse si: hidrocentrale (për çdo fuqi të instaluar), termocentrale, porte, aeroporte, tunele për vepra hidroteknike, bazamente për ngarkesa të mëdha dhe objekte industriale.
h	Vepra hidroteknike – kulla ekuilibri – porte – pontile.	e	Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtime të shkëlqyera me mundësi lëngëzimi.
6	PROJEKTUES RRUGË – HEKURUDHA	f	Studime të rrezikut sizmik në nivel rajonal (mikrozonomie sizmike) dhe në nivel kombëtar (hartat kombëtare të rrezikut sizmik).
a	Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.	13	Studime e projektme të ndërtimit dhe mbylljes së vendëzimeve të mbetjeve të ngurta (urbane). Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).
b	Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.	14	Studime e projektme të ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).
c	Autostrada.		
d	Aeroporte – heliporte – hidroporte.		
e	Hekurudha-degëzime hekurudhore.		

KATEGORITË NË FUSHAT E MBIQEYRJES DHE KOLAUDIMIT TE PUNIMEVE TE ZBATIMIT NE NDERTIM

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI		PUNIME SPECIALE NDERTIMI	
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të ëdura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale.	NS-5	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.	NS-6	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
NP-4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.	NS-7	Barriera dhe mbrojtje rrugore.
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti.	NS-8 a	Ndërtime parafabrikat beton arme.
NP-6 a	Diga të çdo lloj madhësie. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).	NS-8 b	Struktura metalike.
NP-6 b	Diga të vogla (diga me lartësi deri 10 m ose me vëllim uji të grumbulluar deri 1 milion m ³ ose gjatësi kurore dige deri 500 m).	NS-8 c	Struktura druri.
NP-6 c	Tunele hidroteknike.	NS-9	Punime strukturore speciale.
NP-7 a	Ujësjetës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.	NS-10	Shtresa dhe mbistruktura speciale.
NP-7 b	Vepra naftësjetës-gazsjellës-vajsjetës.	NS-11	Punime mbi shina e traversa.
NP-8	Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.	NS-12	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
NP-9	Punime dhe mbrojtje lumore sistemeve hidraulike dhe bonifikime.	NS-13	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
NP-10	Ndërtimi i impianteve të prodhimit të energjisë elektrike. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).	NS-14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.
NP-11	Ndërtime për nënstationet, kabinet e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	NS-15	Pastrimi i ujërave detarë, liqenor dhe lumor.
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	NS-16	Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).
		NS-17	Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve.	NS-18	Punime topogjeodezike.
NS-2	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.	NS-19	Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë.
NS-3	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).	NS-20	Shpime gjeologjiko-inxhinierike, puse e shpime për ujë.
		NS-21	Impiante të trajtimit të ujërave të zeza. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

OKR
Qendra Kombëtare e Regjistrimit
National Registration Center

NUMRI SERIAL:
SN-240814-06-14

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

Personit të tatueshëm:

A.L.T.E.A. & GEOSTUDIO 2000 – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar

Statusi:

Aktiv

Me adresë kryesore:

Tirane, Vore, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 12, Picar Vorë, Ndërtesë tre kate me numër Pronësie 495978 dhe me numër Pasurie 40/57

I jepet ky numër identifikimi (NUIS):

J62026003M

Afati i veprimtarisë:

Nga: 08/08/1994 deri

DATA E REGJISTRIMIT
20/08/1996

DATA E LËSHIMIT
27-06-2014

SPORTELI I SHËRBIMIT:

QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

BLERINA BASHKEXHA
(Emri, Mbiemri) i nëpunësit të spontelit të tatueshëm.

Kjo certifikatë është nënshtruar dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshime të ndonjë detaji ose ndërpritet detyrimi ligjor për të qenë i tatueshëm.

ALTEA GeOSTUDIO

GEOLOGICAL INVESTIGATIONS, GEOTECHNICAL & GEOPHYSICAL STUDIES,
LABORATORY TESTING FOR GEOTECHNICAL & CONSTRUCTION MATERIALS

INVESTIGIME GEOLOGJIKE, STUDIME GJEOTEKNIKE & GJEOFIZIKE, LABORATOR
PER KRYERJEN E PROVAVE TE MATERIALEVE TE NDERTIMIT & STUDIMEVE GJEOTEKNIKE

RAPORT GJEOLIGO-INXHINIERIK I SHESHIT TE NDERTIMIT PER PROJEKTIN
“REHABILITIM I FASADAVE DHE RRUGES “LUIGJ GURAKUQI” DERI NE SHESHIN
“AVNI RUSTEMI” (ME PARKIM 2 KATE NENTOKE), NE TIRANE
(803)

Address: Autostrada Tirane-Durres km 12, Picar Vore
Contact: skender.allkja@alteageostudio.com; +355 68 20 74 332;
ledio.allkja@alteageostudio.com; +355 68 33 36 767
NIPT: J62026003M | N.2101/11 | NZ.2101/7
www.alteageostudio.com

Autor:

Skender Allkja
Besian Xhagolli
Ardita Malaj

Porosites:

"BASHKIA TIRANE"

Tirane, 05/11/2022

Address: Autostrada Tirane-Durres km 12, Picar Vore /
Contact: skender.allkja@alteageostudio.com; +355 68 20 74 332
ledio.allkja@alteageostudio.com; +355 68 33 36 767
NIPT: J62026003M | N.2101/11 | NZ.2101/7
www.alteageostudio.com



EN ISO 9001:2015 No. 010140786
SCC**2011 No. 20106122007136
EN ISO 14001:2015 No. 04 016008
ISO 14001:2015 No. 20152210005785
Pass 99:2012 No.02613005

LT 067110321

Permbajtja

1.0	HYRJE	4
1.1	Qellimi i Studimit	4
1.2	Objektivi i Punimeve	4
2.	GJEOMORFOLOGJIA	5
2.1	Vendodhja e Zones se Studimit dhe Pershkrimi i Relievit.....	5
2.2	Proçeset Fiziko-Gjeologjike dhe Gjeodinamike	5
3.	NDERTIMI GJEOLOGJIK DHE HIDROGJEOLOGJIK.....	6
3.1	Studimet Ekzistuese	6
	Depozitimet e Kuaternarit (Q _{4al}).....	6
	Depozitimet e Neogjenit (N ₁ ^{2t}).....	6
3.2	Kushtet Hidrogjeologjike	7
4.	PUNIMET FUSHORE.....	7
4.1	Qellimi i Punimeve Fushore	7
4.2	Inspektimi i Punimeve ne Terren.....	7
4.3	Planifikimi i Thellesise se Shpimeve si dhe Caktimi i Tyre ne Terren	8
4.4	Shpimet me Rrotullim.....	8
	Pershkrimi i paisjeve te perdorura	8
	Interpretimi i Testeve S.P.T	9
	Marrja e Kampioneve me Strukture te Prishur dhe te Paprishur	10
	Kontrolli i Nivelit te Ujit Nentokesor.....	11
5.	ANALIZAT LABORATORIKE	11
5.1	Qellimi i Provave	11
5.2	Percaktimi i Struktures se Kampionit, Ngjyres dhe Fortesise	12
5.3	Testimet e Dherave.....	12
	Testimet Standarte	12
	Proçedurat e Veçanta per Kampionet me Strukture te Paprishur.....	13
6.	KUSHTET GJEOLOGO – INXHINIERIKE TE SHESHIT TE NDERTIMIT	13
7.	PERFUNDIME DHE REKOMANDIME	16
8.	LITERATURË DHE REFERENCAT E PERDORURA	16
	Aneksi 01. Foto nga puna ne terren	19
	Aneksi 02. Vizatimet.....	27

Lista e Figurave

<i>Figura 1 Karotieri i S.P.T sipas ASTM D 1586-11</i>	8
<i>Figura 2 Vleresimi i aftesise mbajtese nga PP values (penetrometer Xhepi) (cohesive soil) (Look, 2004)</i>	9
<i>Figura 3 Aftesia mbajtese per argjilat S.P.T</i>	9
<i>Figura 4 Rezistenca e te dhenave te S.P.T per rerat e mesme dhe te trasha</i>	9
<i>Figura 5 Aftesia mbajtese e llogaritur nga te dhenat e S.P.T per rerat e imta dhe rerat kokerr-trasha</i>	10

1.0 HYRJE

Me kerkese te "**BASHKISE TIRANE**", u krye studimi i kushteve gjeologo-inxhinierike te sheshit te ndertimit per projektin "**Rehabilitim i fasadave dhe rrugës "Luigj Gurakuqi" deri ne sheshin "Avni Rustemi" (me parkim dy kate nëntokë)**", ne Tirane.

Studimi eshte kryer bazuar ne nje program te hartuar nga "**A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000**", i cili eshte miratuar nga "**BASHKIA TIRANE**". Per zbatimin e ketij programi eshte bere nje marreveshje ndermjet dy paleve. Per realizimin e ketij studimi jane kryer punet e meposhtme:

- a) Jane kryer 3 shpime me thellesi 15.00-20.00m qe jane kryer prane ketij sheshi ndertimit (sipas rekomandimeve qe jepen ne ASTM dhe BSI Standard).
- b) Jane kryer 12 prova te tipit SPT sipas metodikes (ISSMFE techn. Committee 1988. International Reference Test Procedure).
- c) Jane kryer 10 analiza granulometrike me sitat ASTM -series, sipas normatives ASTM D6913-04(2009) e1 dhe ASTM D 7928-16e1.
- d) Jane kryer 10 analiza Atterberg Limits sipas metodikes ASTM D 4318-17e1.
- e) Jane kryer 4 teste Odeometric Test sipas metodikes ASTM D2435/2435 M-11.
- f) Jane kryer 4 teste Shear Test sipas metodikes SSH EN ISO 17892-10:2018.
- g) Eshte bere interpretimi i te dhenave INSITU, te dhenave te laboratorit dhe hartimi i raportit perfundimtar.
- h) Thellesia e shpimeve 20.00m, eshte projektuar per te studiuar depozitimet e Kuaternarit deri ne thellesine e pritshme per te takuar ndonje zone me depozitime te dobeta, e cila kerkon masa inxhinierike per te perforcuar thermelet me qellim qe te mos kete mundesi qe te ndodhin pasoja negative gjate ndertimit dhe shfrytzezimit te objekteve.

1.1 Qellimi i Studimit

Qellimi i ketij studimi eshte percaktimi i karakteristikave fiziko-mekanike te dherave dhe shkembinjve qe takohen ne zonen e porositur nga "**BASHKIA TIRANE**". Te dhenat e marra nga punimet fushore dhe ato laboratorike do t'i sherbejne projektuesve per te parashikuar projektin e themeleve te kateve nentoke dhe pjeseve te tjera te projektit te ketij sheshi ndertimi. Ne kete studim do te japim rekomandime per menyren e themelimit te objekteve te reja si dhe organizimit te dyshemeve te kateve perdhe per te eleminuar uljet e diferencuara si dhe per mbrojtjen e skarpatave, meqenese projekti do te jete dy kate nentoke dhe ngjitur me zonen e ndertimit ka godina ekzistuese me themele te ceketa.

1.2 Objektivi i Punimeve

Shkurtimisht raporti shqyrton çështjet te cilat jane te mbeshtetura me punimet gjeologjike sipas programit te miratuar nga porositesi dhe te zbatuar nga "**A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000**".

- a) Jane rishikuar te gjitha punimet e meparshme gjeologjike te kryera nga autoret e ketij studimi dhe nga autore te tjere vendas, te cilat jane kryer per qellime te tjera por kane vlera njohese. Jane pare te gjitha studimet e botuara dhe te pa botuara per zonen ne fjale.
- b) Jane studiuar punimet gjeologjike te vjetra qe jane kryer per zonen e qytetit ne Tirane, hartat gjeologjike dhe gjeomorfologjike te zones ku do te ndertohen objektet e reja.
- c) Jane kryer punime te ndryshme sipas programit te hartuar me siper, por te kombinuar dhe me punimet ekzistuese te cilat jane shume te rendesishme per te kuptuar

fenomenet gjeologjike qe kane ndodhur ne zhvillimin e historikut gjeologjik te kesaj zone.

- d) Nje rendesi te veçante kane dhe testimet ne laborator te kampioneve te marre ne terren nga shpimet.

Per kryerjen e ketij studimi jane shfrytezuar punimet e meparshme te kryera per zonen ne fjale siç jane:

1. Studimi gjeologo-inxhinierik dhe gjeoteknik i kryer nga ndermarrja Gjeologji-Gjeodezi per qytetin e Tiranës. Tirane 1950-1990.
2. Studimi gjeologo-inxhinierik dhe gjeoteknik i kryer nga "A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000" per qytetin e Tiranës dhe per zonen prane sheshit "Avni Rustemi" ne Tirane, ne veçanti. Viti 1999-Shtator 2022.

Studimet jane kryer konform standarteve qe jane ne marreveshjen e bere ndermjet paleve siç jane: ASTM, AASHTO, BSI, UNI EN.

2. GJEOMORFOLOGJIA

Ne kete kapitull do te behet pershkrimi i zones ku shtrihet sheshi "Avni Rustemi"; format e relievit te sotem dhe te hershem, kushtet gjeologjike te formimit te ketij relievi. Do te behet pershkrimi i fenomeneve gjeologjike dhe gjeodinamike te zones.

2.1 Vendodhja e Zones se Studimit dhe Pershkrimi i Relievit

Vendi ku do te kryhet projekti ndodhet nga rruga "Luigj Gurakuqi" deri ne sheshin "Avni Rustemi", ne Tirane. Sheshi i ndertimit ndodhet ne tarracen e lumit Lana, e cila eshte e rrafshet dhe me diference te vogel kuotash. Vendi ku do te kryhet projekti ne kushtet aktuale eshte bosh i rrethuar me godina te vogla me lartesi 2-3 kate dhe me ndertime te reja. Fusha e Tiranës eshte me origjine aluviale ku ne te jane prezente dhe depozitimet e fraksioneve te imeta te pakonsoliduara, te cilat kane permbajtje te lendes organike. Nen keto depozitime takohen shkembinjte Neogjenike, qe perbehen nga argjilite dhe ranore. Depozitimet Neogjenike kane trashesi 100-250m.

2.2 Proçeset Fiziko-Gjeologjike dhe Gjeodinamike

Ne studimin e fenomeneve gjeologjike te kesaj zone jemi bazuar ne studimet ekzistuese dhe ne informacionet e reja qe kemi marre nga studimi aktual. Bazuar ne keto te dhena po bejme pershkrimin e fenomeneve gjeologjike qe jane prezente ne formacionet gjeologjike qe takohen ne kete zone.

Fenomenet me te dukshme gjeologjike dhe gjeodinamike qe verehen ne kete zone jane:

1. Fenomeni i perajrimit
2. Fenomeni i konsolidimit te depozitimeve aluviale

Keto fenomene po i shpjegojme nje nga nje me poshte:

1. Fenomeni i perajrimit eshte i dukshem tek formacionet rrenjesore qe perbehen nga argjilite dhe alevrolite. Keta shkembinj jane depozitime te reja dhe me çimentim te dobet argjilor. Ato nen veprimin e agjenteve atmosferike transformohen nga shkembinj te bute ne dhera. Ky fenomen takohet me teper ne pjesen kodrinore te zones siç jane kodrat e Dajtit, Paskuqanit dhe kodrat e Selites.
2. Fenomeni i konsolidimit te depozitimeve aluviale. Keto depozitime perbehen nga shtresa suargjilash, surerash, zhavorre dhe argjilash me permbajtje lendesh organike.

Ne kete pjese te fushes se Tiranes jane te vendosura depozitimet e lumit Lana, te cilat nderthuren me depozitimet e perrenjve te zones. Ne kohe te ndryshme kjo fushe ka qene dhe nje liqen i mbyllur ne te cilin jane depozituar materiale me granulometri te imet dhe lende organike. Shtresat qe permbajne lende organike jane te pak konsoliduara deri mesatarisht te konsoliduara. Ne sheshin e studiuar nuk jane takuar shtresa te tilla, por neqoftese do te takohen gjate zbatimit te punimeve duhet te konsultohet situata me projektuesin dhe me gjeologun e punimeve. Niveli i ujit nentokesor eshte afer siperfaqes se tokes. Nga prerjet gjeologjike qe jane ne kete raport duket ndertimi linzor i ketij sheshi ndertimi. Per te eliminuar kete heterogjenitet rekomandojme qe para betonimit te themeleve te shtrohet nje shtrese zhavorri ose çakelli me trashesi 30-40cm, e cila do te beje nje uniformitet te bazes se themeleve te objekteve. Zhavorri duhet te jete me granulometri te rregullt me dimensione 0-70 mm ose shkemb i thyer me te njenjten granulometri.

3. NDERTIMI GJEOLOGJIK DHE HIDROGJEOLOGJIK

Ne kete kapitull do te trajtojme perberjen gjeologjike te zones duke shfrytezuar punimet ekzistuese dhe punimet e kryera ne terren nga "A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000". Bazuar ne materialin e grumbulluar po shtjellojme kushtet gjeologjike te ndare ne studimet ekzistuese dhe ne studimet e reja te kryera nga grupi i studimit.

3.1 Studimet Ekzistuese

Ne zonen e qytetit te Tiranes jane kryer shume studime rajonale dhe lokale. Keto studime jane kryer per objektet e ndryshme qe kane te bejne me identifikimin e shtresave me karakteristika te dobeta, qe jane prezente ne kete rajon si dhe per projektimin e themeleve te godinave te reja shumekateshe qe jane ndertuar ne kete zone.

Tarraca e Tiranes ben pjese ne zonen e Ultesires Perendimore te Shqiperise, ne Ultesiren e Tiranes. Ne kete zone jane prezente depozitimet Neogjenike dhe depozitimet e Kuaternarit, por ne zonen ku do te ndertohen objektet e reja jane prezente depozitimet e meposhtme:

Depozitimet e Kuaternarit (Q_{4a})

Depozitimet aluvialo-eluviale. Perfaqesohen nga suargjila te mesme deri te renda, surera, rera zhavorre dhe argjila. Jane depozitime pak deri ne mesatarisht te konsoliduara, takohen ne gjithë zonen ku do te kryhet projekti ne pjesen siperfaqesore dhe ka trashesi 20.00-23.00m. Keto depozitime siç e kemi permendur jane pak deri te pakonsoliduara me permbajtje te lendes organike sidomos surerat dhe argjilat me permbajtje te lendes organike. Ne kete zone, niveli i ujit nentokesor eshte afer siperfaqes se tokes dhe ka pasur kushte per t'u konsoliduar ne menyre natyrore. Prezenca e lendes organike ka zgjatur kohen e konsolidimit te ketyre depozitimeve. Nderthurja e depozitimeve te Lanes me depozitimeve te perrenjve perreth ka bere qe shtresat te jene ne formen e linzave shume heterogjene dhe t'a veshtiresojne identifikimin e tyre. Por ne studimin e paraqitur eshte bere nje perpjekje maksimale per te dhene nje detajim te mjaftueshem per projektimin e themeleve.

Depozitimet e Neogjenit (N₁^{2t})

Nen depozitimet e Kuaternarit takohen depozitimet e Neogjenit qe perbehen nga argjilite dhe alevrolite me ngjyre gri, me çimentim te dobet deri mesatar. Pjesa e siperme e ketyre depozitimeve eshte e perajruar. Keto depozitime dalin ne siparfaqe ne kodrat e Selites dhe te

Address: Autostrada Tirane-Durres km 12, Picar Vore /

Contact: skender.allkja@alteageostudio.com; +355 68 20 74 332

ledio.allkja@alteageostudio.com; +355 68 33 36 767

NIPT: J62026003M | N.2101/11 | NZ.2101/7

www.alteageostudio.com

Dajtit ne rrethin e Tiranes. Keto depozitime nuk jane te rendesishme neqoftese themelet zgjidhen me pllake betoni te armuar, por ne qoftese do te perdoren themele te thella ato jane me te rendesishmit dhe kane parametra te mire fiziko-mekanike.

3.2 Kushtet Hidrogjeologjike

Nga studimet e kryera ne zonen e qytetit te Tiranes (nga matjet e kryera ne shpimet per disa vite ne punimet e ndryshme qe autoret kane kryer per kete zone), rezulton se niveli i ujit nentokesor ne dimer dhe ne vere eshte i ndryshem. Ky vit ka qene nje vit me pak rreshje dhe niveli i ujit nentokesor eshte takuar me thelle se vitet e tjera me rreshje normale ne dimer. Autoret e ketij studimi kane shfrytezuar te gjitha punimet ekzistuese dhe punimet e reja. Jane kryer matje ne disa kohe gjate gjithë periudhes se studimit dhe rezulton se ne pjesen me te madhe te zones niveli i ujit nentokesor eshte shume afer siperfaqes se tokës (-2.50m dhe ne vere eshte -5.40m). Ne zonen e studiuar, ne momentin e shpimeve nuk ka pasur rreshje masive dhe levizje te rrymave te ujrave siperfaqesore, te cilat mund te kene ndikuar tek niveli i ujit nentokesor. Niveli i takuar eshte niveli minimal i ujit nentokesor i matur ne 16/01/2021 dhe eshte (7.50m) nga toka natyrore. Nuk perjashtohet mundesia qe ne periudhe me rreshje masive niveli i ujit te ngrihet deri ne thellesine (-2.50m). Nga analizat laboratorike ne kemi konstatuar se shtresat ne sheshin e ndertimit jane me perberje argjilore dhe me pershkueshmeri te ulet. Kjo tregon se gjate hapjes se gropes do te kete sasira te vogla te ujrave nentokesore, te cilat me anen e pompave mund te largohen nga gropa e themelit. Rekomandojme qe rrymat e ujrave siperfaqesore te largohen nga skarpatat e gropes se themelit, sepse ato behen shkak per prishjen e qendrueshmerise se tyre. Nga analizat e kryera rezulton se jane ujera neutrale dhe ato nuk jane agresive ndaj hekurit dhe betonit.

4. PUNIMET FUSHORE

Per percaktimin e kushteve te detajuara gjeologjike dhe gjeoteknike te zones ku do te kryhet projekti ne sheshin "Avni Rustemi" ne Tirane, ne bashkepunim me investitorin eshte hartuar nje program i detajuar, i cili eshte respektuar nga "**A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000**".

4.1 Qellimi i Punimeve Fushore

Punimet fushore kane per qellim te percaktojne ne terren karakteristikat e formacioneve gjeologjike ne zonen ku do te kryhet projekti ne Tirane. Ne fazen e punimeve fushore jane marre dhe kampionet me strukture te prishur dhe te paprishur per t'u analizuar ne laborator. Ne kete faze jane identifikuar dhe fenomenet negative fiziko-gjeologjike qe jane prezente ne kete zone.

4.2 Inspektimi i Punimeve ne Terren

Te gjitha punimet fushore si rilevimet gjeologjike dhe shpimet jane kryer nen mbikqyrjen e inxhinierëve te kompanise "**A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000**" dhe ne te shumten e rasteve jane inspektuar nga perfaqesuesi i "**BASHKISE TIRANE**". Inxhinieret e kompanise kane mbajtur te gjitha shenimet fushore te cilat jane krahasuar me te dhenat laboratorike. Mbi bazen e te dhenave te korektuara nga pershkrimi fushor dhe rezultatet laboratorike eshte bere perpilimi i Raportit Gjeologjik.

4.3 Planifikimi i Thellegesise se Shpimeve si dhe Caktimi i Tyre ne Terren

Para fillimit te punes ne terren eshte bere studimi i draftit te projektit te detajuar mbi bazen e te cilit jane projektuar punimet fushore.

Per te vleresuar kushtet gjeologjike te zones ku do kryhet projekti i ri, per kete faze studimi jane kryer 3 shpime me thellesi 15.00-20.00m. Kjo thellesi eshte percaktuar, sepse punimet e meparshme te kryera nga "A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000" kane identifikuar zona te dyshimta qe kompromentojne qendrueshmerine e objekteve deri ne thellesine 20.00m.

Te gjitha punimet ne fillim jane aprovuar nga investitori dhe projektuesit te objekteve.

4.4 Shpimet me Rrotullim

Punimet kryesore qe jane kryer ne studimin gjeoteknik te objekteve te reja jane shpimet me rrotullim, te cilat jane kryer sipas rrejtit qe kemi pershkruar me siper.

Pershkrimi i paisjeve te perdorura

Shpimet ne zonen e sheshit "Avni Rustemi" jane realizuar me nje pajisje shpimi, te cilen do t'a pershkruajme si me poshte:

- Autosonde Tip "CMV 600" prodhim Italian e montuar ne nje traktor ne Republikën e Italise.

Ne terren jane kryer testime S.P.T ne borehole sipas programit te hartuar ne bashkepunim me porositesin. Ndryshimet jane te miratuara prej projektuesve dhe porositesit.

Prametrat e Standart Penetration Test S.P.T

Pesha e çekiçit te S.P.T	63.50 kg
Pesha e shtangave te shpimit me 50mm diameter	10.00 kg/ml
Lartesia e goditjes se çekiçit	76.40cm
Diametri i brendeshem e karotierit te S.P.T	34.90 mm

Para çdo ekzekutimi te testit S.P.T, fundi i pusit eshte pastruar me kujdes dhe pastaj thellesia e tij eshte matur. Gjithashtu thellesia e pusit eshte matur pas testit te kryer. Gjeologu qe eshte ne terren jep nje perfundim lidhur me anomalite e testit S.P.T, neqoftese eshte prej efekteve gjeologjike, ose per shkak se testi nuk eshte kryer ne menyre te drejte. Nese testi ka pesuar defekt jo prej fenomeneve gjeologjike te cilat jane pasoje mos respektimit te rregullave, ky test eshte kryer perseri. Kur testi i kryer ka rezultate te pa pranueshme sepse kishte anomali ne strukturen gjeologjike, ne komentet tona jane dhene arsyet pse testi nuk eshte normal. Sa here qe ky test eshte kryer, pusi i shpimit ka qene i mbushur me uje. Para se testi te kryhet, fundi i pusit eshte pastruar dhe struktura e tokes eshte ne gjendjen e saj natyrale. Pas çdo testi te kryer eshte hapur "karotieri S.P.T" dhe eshte bere pershkrimi i tokes dhe me pas eshte marre kampioni dhe eshte vendosur ne qeska plastike. Karotieri S.P.T ka dimensionet qe jane A = 78mm, B = 570mm. Pesha e çekiçit qe fryn eshte 63.5kg, defekt lartesia eshte 76 cm.

Te dhenat e karotierit S.P.T qe eshte perdorur ne kete projekt:




Figura 1 Karotieri i S.P.T sipas ASTM D 1586-11

Interpretimi i Testeve S.P.T

Sipas librit "Handbook of Geotechnical Investigation and Design Tables"- me autor Burt Look, botimi i dyte, ka disa tabela korektuese per SPT N-vlera per tokat e lidhura (for both cohesive & non-cohesive soils):

Table 5.2 Evaluating strength from PP values (Look, 2004).

Material	Unconfined compressive strength q_u
In general	0.8 PP
Fills	1.15 PP
Fissured clays	0.6 PP

Figura 2 Vleresimi i aftesise mbajttese nga PP values (penetrometer Xhepi) (cohesive soil) (Look, 2004)

Table 5.3 Clay strength from SPT data.

Material	Description	SPT – N (blows/300 mm)	Strength
Clay	Very Soft	≤ 2	0–12 kPa
	Soft	2–5	12–25 kPa
	Firm	5–10	25–50 kPa
	Stiff	10–20	50–100 kPa
	Very Stiff	20–40	100–200 kPa
	Hard	> 40	> 200 kPa

Figura 3 Aftesia mbajttese per argjilat S.P.T

Table 5.5 Strength from SPT on clean medium size sands only.

Description	Relative density D_r	SPT – N (blows/300 mm)		Strength
		Uncorrected field value	Corrected value	Friction angle
Very loose	$< 15\%$	$N \leq 4$	$(N_o)_{60} \leq 3$	$\phi < 28^\circ$
Loose	15–35%	$N = 4-10$	$(N_o)_{60} = 3-8$	$\phi = 28-30^\circ$
Med dense	35–65%	$N = 10-30$	$(N_o)_{60} = 8-25$	$\phi = 30-40^\circ$
Dense	65–85%	$N = 30-50$	$(N_o)_{60} = 25-43$	$\phi = 40-45^\circ$
Very dense	$> 85\%$	$N > 50$	$(N_o)_{60} > 43$	$\phi = 45^\circ$

- Reduce ϕ by $\sim 5^\circ$ for clayey sand.
- Increase ϕ by $\sim 5^\circ$ for gravelly sand.

Figura 4 Rezistenca e te dhenave te S.P.T per rerrat e mesme dhe te trasha

Table 5.6 Strength from corrected SPT value on clean fine and coarse size sands.

Description	Relative density D_r	Corrected SPT – N (blows/300 mm)			Strength
		Fine sand	Medium	Coarse sand	
V. loose	<15%	$(N_o)_{60} \leq 3$	$(N_o)_{60} \leq 3$	$(N_o)_{60} \leq 3$	$\phi < 28^\circ$
Loose	15–35%	$(N_o)_{60} = 3–7$	$(N_o)_{60} = 3–8$	$(N_o)_{60} = 3–8$	$\phi = 28–30^\circ$
Med dense	35–65%	$(N_o)_{60} = 7–23$	$(N_o)_{60} = 8–25$	$(N_o)_{60} = 8–27$	$\phi = 30–40^\circ$
Dense	65–85%	$(N_o)_{60} = 23–40$	$(N_o)_{60} = 25–43$	$(N_o)_{60} = 27–47$	$\phi = 40–45^\circ$
V. dense	>85%	$(N_o)_{60} > 40$	$(N_o)_{60} > 43$	$(N_o)_{60} > 47$	$\phi = 45–50^\circ$
	100%	$(N_o)_{60} = 55$	$(N_o)_{60} = 60$	$(N_o)_{60} = 65$	$\phi = 50^\circ$

- o Above is based on Skempton (1988):
 - $(N_o)_{60}/D_r^2 = 55$ for Fine Sands.
 - $(N_o)_{60}/D_r^2 = 60$ for Medium Sands.
 - $(N_o)_{60}/D_r^2 = 65$ for Coarse Sands.

Figura 5 Aftesia mbajttese e llogaritur nga te dhenat e S.P.T per rerat e imta dhe rerat kokerr-trasha.

Metodika e perdorur per menyren e shpimit ne dhera dhe ne shkembinj, kryerjen e provave me S.P.T ne borehole, marrja e kampioneve me strukture te prishur dhe te paprishur eshte kryer sipas metodikes se pershkruar ne ASTM dhe BSI Standard.

Marrja e Kampioneve me Strukture te Prishur dhe te Paprishur

Shpimet jane realizuar me autosonda me menyre shpimi me rrotullim tipi "Craelius", ku njera sonde eshte e tipit "CMV 600" e montuar ne nje traktor. Menyra e shpimit realizohet duke shpuar me nje karotier (core drilling) me diameter $\phi=100\text{mm}$, gjatesi sipas rastit 2.00-3.00m dhe pusi (hole) mbrohet me tub rrethimi (casing) (tub metalik me diameter $\phi=150\text{mm}$). Mbase mbarohet nje manover shpimi me karotier, futet nje tub rrethimi, pastrohet pusi deri ne thellesine e shpuar me pare duke treguar vemendje qe struktura e tokes te mos priset, pastaj sipas programit ekzekutohet nje test ose merret nje kampion me strukture te paprishur (tipi shelby). Gjate gjithes kohes pusi eshte i mbushur deri ne gryke me uje.

Menyra e nxjerrjes se kampionit nga karotieri (core drilling) eshte me presion me nje pompe, e cila formon nje perzierje ajer dhe uje. Shtangat e shpimit (rods) jane me gjatesi 1.50-3.00m dhe me peshe 10kg/ml.

Gjatesia e manovrave te shpimit kryhet sipas porosise se inxhinierit te objektit. Nga ana e grupit te shpimit te "A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000" tregohet vemendje qe te respektohet me korrektesi zbatimi i porosive te inxhinierit duke siguruar qe struktura e tokes te ruhet e paprishur ne te gjitha rastet kur do te kryheshin prova ne pus (borehole) ose kur do te merrej kampion me strukture te paprishur.

Marrja e kampioneve

Ne studimet gjeologjike dhe gjeoteknike parashikohet te merren disa lloje kampionesh te cilat sherbejne per te identifikuar cilesite e dherave. Te cilat me hollesisht po i trajtojme me poshte.

1. Kampione me strukture te prishur nga Testet (S.P.T) i cili eshte quajtur D_{spt} . Ky lloj kampioni eshte marre ne kete menyre: Sapo mbaron prova S.P.T, hapet Core spt dhe behet pershkrimi i kampionit, pastaj futet ne nje qese plastike dhe mbeshtillet me skoq

me qellim qe te ruhet lageshtia natyrore. Keto kampione vlejne per te matur lageshtine dhe per te bere analiza identifikimi.

2. Kampione me strukture te prishur te tipit small disturbed sample qe jane shenuar me "D". Pesha e kampioneve eshte marre sipas tipit te llojit te dherave sasia ne peshe e tyre. Per keto kampione jane zbatuar keto menyra marrje: Menjehere sapo del kampioni nga Core Drilling, behet pershkrimi i tij dhe futet ne nje qese plastike, pastaj mbeshillet me skoç me qellim qe te ruaje lageshtine natyrore. Te gjitha kampionet ruhen ne arka plastike qe te mos demtohen gjate transportimit per ne laborator. Njekohesisht gjate dites ruhen ne vende te fresketa qe te mos demtohen nga veprimi e rrezeve te diellit.
3. Kampione bulk disturbed samples sipas tipit te dherave ato jane marre ne keto permasa: Per argjilat (clay), fine sand and silt jane marre me peshe = 3kg. Per rerat kokerr-mesme me peshe = 5kg. Dhe keto kampione siç e kemi pershkruar me siper, menjehere sapo kampioni del nga Core Drilling, behet pershkrimi i tij dhe pastaj futet ne qese plastike, mbeshillet me skoç dhe pastaj ruhet me kujdes ne arka plastike.
4. Kampione me strukture te paprishur ne tubo metalike me diameter $\phi=100 \times 550$ mm dhe $\phi=80 \times 550$ mm. Per te realizuar marrjen e ketyre kampioneve, ne fillim jane pergatitur tubo metalike me gjatesi te pergjithshme 600mm dhe gjatesia efektive e tubit me kampion eshte 550mm. Para se te merret kampioni, trangu i pusit eshte i pastruar dhe i mbushur deri ne gryke me uje. Mbasi te jete realizuar, fundi i pusit i paster me toke natyrore te paprishur futet instrumenti per marrjen e kampionit, i cili mbasi arrin ne ballin e pusit (fundi i tij ose Botom), shtyhet instrumenti pa rrotullim me gjatesine e tubit metalik, i cili eshte 600mm dhe menjehere ngrihet instrumenti deri ne siperfaqe per te marre kampionin. Mbasi del kampioni, pastrohet tubi metalik dhe pastaj ne te dy anet, rreth 20mm mbushen me parafine dhe ne fund mbeshillet me skoç i gjithë kampioni. Shenohet etiketa e marrjes se kampionit (ose adresa e marrjes se tij). Ne te gjitha rastet matet thellesia e marrjes se kampionit para dhe mbas ekzekutimit te tij. Keto kampione ruhen me kujdes ne arka plastike qe te mos demtohen gjate udhetimit per ne laborator.

Kontrolli i Nivelit te Ujit Nentokesor

Nga ana e inxhinierëve te "A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000" eshte treguar nje vemendje e veçante per matjen e nivelit te ujit nentokesor. Ne programin e studimit gjeologjik nuk jane parashikuar monitorimet e nivelit te ujit nentokesor per nje kohe te gjate. Per kete arsye, monitorimi i ujit nentokesor eshte bere per nje periudhe prej 24 ore deri ne maksimum 96 ore. Eshte shenuar thellesia e takimit te nivelit te ujit gjate shpimit dhe niveli i stabilizuar i ujit nentokesor. Ne prerjen e çdo sonde eshte shenuar niveli i ujit nentokesor i stabilizuar per nje periudhe jo me te shkurter se 24 ore.

5. ANALIZAT LABORATORIKE

5.1 Qellimi i Provave

Sipas programit te hartuar ne bashkepunim me perfaqesuesit e "BASHKISE TIRANE" jane kryer testimet laboratorike te mostrave te marra ne zonen ku do te kryhet projekti "Rehabilitim i fasadave dhe rrugës "Luigj Gurakuqi" deri ne sheshin "Avni Rustemi" (me parkim dy kate nëntokë)", ne Tirane. Testimet u kryen per te percaktuar karakteristikat fiziko-mekanike

Address: Autostrada Tirane-Durres km 12, Picar Vore /

Contact: skender.allkja@alteageostudio.com; +355 68 20 74 332

ledio.allkja@alteageostudio.com; +355 68 33 36 767

NIPT: J62026003M | N.2101/11 | NZ.2101/7

www.alteageostudio.com



EN ISO 9001:2015
SCC**2011
EN ISO 14001:2015
ISO 14001:2015
Pass 99:2012

No. 010140786
No. 20106122007136
No. 04 016008
No. 20152210005785
No.02613005

LT 067110321

te llojeve të dherave dhe të shkëmbinjve, të cilat ishin me strukture të prishur dhe të paprishur. Keto kampione janë marrë nga shpimet. Analizat janë kryer në laboratorin e "A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000", në Tiranë.

Provat laboratorike janë kryer duke ndjekur kërkesat e kontraktorit dhe të konsulentit, si dhe duke ndjekur procedurat në fuqi të Manualit të Cilesisë të laboratorit "A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000", i cili është i çertifikuar nga TUV Austria.

Keto procedura që janë konform manualit të cilesisë EN ISO 9001: 2015 dhe konform manualit S SH ISO/IEC 17025-2017, garantojnë cilesinë dhe saktësinë, si dhe një raport të plotë e të hollësishëm të provave të kryera.

Kualifikimi i lartë i stafit të laboratorit garanton kryerjen e të gjitha provave gjeoteknike të kerkuara në këtë raport. Drejtuesit e laboratorit vendosin për programin e kryerjes së provave në përputhje me kërkesat e porositesit dhe konsulentit. Drejtuesit e laboratorit janë përgjegjës për çdo rezultat prove të leshuar.

Pajisjet dhe instrumentet matëse të laboratorit të vlefshme për keto prova ruhen shumë mire, në mënyrë që të garantojnë kryerjen e sakte të provës. Çdo pajisje kontrollohet periodikisht sipas procedurës së Manualit të Cilesisë.

5.2 Percaktimi i Struktura se Kampionit, Ngjyres dhe Fortesise

Për klasifikimin e kampioneve të testuara është ndjekur një procedurë rigorozë ku çdo kampioni i është vendosur një targë perkatese, sipas të ciles identifikohet plotesisht origjina e kampionit, vendmarrja, thellesia dhe të gjitha hollësitë e tjera të nevojshme. Kampionet e mbërritura në laborator janë ruajtur me kujdesin maksimal, në temperaturë dhe lagështi në mënyrë që të mos kishte ndryshime të karakteristikave të tyre origjinale.

Duke zbatuar kërkesat e kontraktorit dhe konsulentit, në laborator u kryen provat e mëposhtme:

- Hapja e kampioneve me strukture të paprishur nga cilindrat metalike me ane të një Hidraulic Extruder. Përshkrimi i kampioneve sipas BSI 1377-1:1990 3/3.2.
- Percaktimi lagështires natyrore, duke ndjekur normativen ASTM D 2216-19.
- Percaktimi i kufinjve të plasticitetit, duke ndjekur normativen ASTM D 4318-17el.
- Percaktimi i Peshes Specifike duke ndjekur normativen ASTM D 854-14.
- Percaktimi i Peshes Volumore duke ndjekur normativen ASTM D 7263-09(2018)e2.
- Percaktimi i perberjes granulometrike me sitat të tipit ASTM -series, sipas normatives ASTM D6913-04(2009) e1.
- Percaktimi i perberjes granulometrike të fraksionit të imet, e cila u krye në materialin që kalon siten ASTM - 0.075mm, sipas normatives ASTM D 7928-16e1.

5.3 Testimet e Dherave

Testimet Standarte

Në kemi përshkruar me siper mënyrën e kryerjes së analizave të identifikimit të llojeve të dherave që kanë mberitur në Laborator si dhe standartet e përdorura. Në laboratorin e "A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000" provat janë kryer bazuar në standartet BS (British Standard), ASTM, AASHTO, BSI, UNI EN. Në çdo çertifikatë të testeve janë të shënuar dhe standartet e përdorura për realizimin e provës. Pajisjet që disponon laboratori janë të përshtatshme për të kryer testimet sipas standardeve të mesiperme.

Proçedurat e Veçanta per Kampionet me Struktura te Paprishur

Kampionet me struktura te paprishur jane te ruajtur ne tubo metalike me gjatesi 600mm, te cilat nuk lejojne qe te behet ne terren pershkrimi i kampionit qe eshte brenda ne tub. Ne terren pershkruhen vetem dy pjeset anesore te tij. Kampioni del nga tubi me anen e hidraulik ekstruder dhe behet pershkrimi i tij nga inxhinieri i laboratorit. Pershkruhet lloji i dheut, ngjyra, kompaktesia, dhe struktura. Zgjidhet pjesa qendrore e kampionit per t'u analizuar, e cila perfaqeson pjesen me te paprishur te kampionit dhe sipas rastit sipas programit fillojne testimet, testimet e klasifimit te dherave te cilat i kemi pershkruar me siper metodiken e perdorur. Testimet me te rendesishme per keto tipe kampionesh jane:

- Prova e One-Dimensional Consolidation (oedometric test) duke rritur ngarkesen ne kampionet cilindrike (Diametri = 50.27mm dhe Lartesi = 20mm), duke ndjekur proçeduren ASTM D 2435/2435 M-11. Ngarkesat e perdorura zgjidhen ne funksion te thellesise se marrjes se kampionit, ne funksion te ngarkeses qe do te ushtrohet nga objekti qe do te vendoset mbi shtresat gjeologjike nga te cilat eshte marre ky kampion. Nga ky testim, vleresohen parametra shume te rendesishme siç eshte koha e llogaritjes se uljeve te shtresave mbasi eshte vendosur ngarkesa e objekteve qe do te ndertohen. Llogaritet dhe madhesia e uljeve. Keto jane parametra shume te rendesishme per objektet qe do te ndertohen. Bazuar ne ambientin gjeologjik qe eshte takuar ne terren kemi parashikuar dhe numrin e provave One-dimensional Consolidation. Ne kete studim disa nga analizat e provave te ometrit nuk perputhen me pershkrimet fushore dhe per te eliminuar ndonje gabim te rastit qe mund te behet gjate llogaritjes se themeleve ne nuk po i paraqesim rezultatet e provave por po japim ne tekst te dhenat e nxjerra nga keto prova.
- Prova e Direct Shear Test Consolidated Drained Conditions ne kampione katrore me gjeresi = gjatesi 60mm dhe lartesi 30mm, duke ndjekur proçeduren SSH EN ISO 17892-10:2018. Keto teste jane shume te rendesishme dhe jane kryer sipas udhezimeve te dhena nga Eng. Charles Scott Dunn, specialist me shume eksperience ne fushen e mekanikes se dherave, per te marre parametra te drenuara duke prere kampionin me nje shpejtesi sipas llojit te dheut duke llogaritur kohen e konsolidimit dhe te drenimit te tij. Keto parametra jane te rendesishme per llogaritjet e themeleve te objekteve. Keto prova nuk jane paraqitur sepse disa nga keto kane te dhena kontraktore. Rezultatet e pranueshme jane dhene ne tekst ne kapitullin: Kushtet gjeologo-inxhinierike te sheshit te ndertimit.
- Prova e Triaksialit eshte kryer sipas metodikes se pershkruar ne ASTM D4767-11 dhe ASTM D2850-15. Per kete objekt nuk jane kryer prova triaksialit, sepse nuk ishte e domosdoshme.

6. KUSHTET GJEOLIGO – INXHINIERIKE TE SHESHIT TE NDERTIMIT

Bazuar ne vrojtimet fushore, perberjen litologjike te sheshit te ndertimit, provat "INSITU" dhe karakteristikat fiziko-mekanike te dherave dhe shkembinjve qe takohen ne sheshin e studiuar, kemi veçuar 5 (pese) shtresa, te cilat po i trajtojme ne veçanti me poshte:

Shtresa Nr.1

Perfaqesohet nga; Mbushje dheu dhe zhavorre, kryer nga veprimtaria e njeriut. Mbetje inerte te materialeve te ndertimit, suargjila dhe surera me ngjyre kafe ne gri. Jane pak te ngjeshura.

Address: Autostrada Tirane-Durres km 12, Picar Vore /

Contact: skender.allkja@alteageostudio.com; +355 68 20 74 332

ledio.allkja@alteageostudio.com; +355 68 33 36 767

NIPT: J62026003M | N.2101/11 | NZ.2101/7

www.alteageostudio.com

Rekomandojme qe ne kete shtrese te mos mbeshteten themele te objektit. Kjo eshte e vlefshme edhe per ndertimet me lartesi te vogel. Takohet ne thellesite: shiko prerjet gjeologjiko-litologjike.

Shtresa Nr.2

Perfaqesohet nga; Suargjila te mesme deri te lehta ngjyre bezhe ne kafe te kuqerremte, me lageshtire, plastike. Permbajne shtresa te holla rere, surere dhe guriçka te vogla. Jane mesatarisht te ngjeshura. Takohet ne thellesite: shiko prerjet gjeologjiko-litologjike.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja granulometrike

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	32.60 %
Fraksioni pluhuror	0.002-0.075 mm	39.70 %
Fraksioni rere	< 4.75 mm	21.90 %
Fraksioni Zhavoror	> 4.75mm	5.80 %

Plasticiteti

Kufiri i siperm i plasticitetit	Wrr = 40.60 %
Kufiri i poshtem i plasticitetit	Wp = 21.30 %
Numri i plasticitetit	Ip = 19.3
Lageshtia natyrore	Wn = 26.80 %
Pesha specifike	$\delta = 2.67 \text{ gr/cm}^3$
Pesha volumore ne gjendje natyrale	$\Delta = 1.96 \text{ gr/cm}^3$
Koeficienti i porozitetit	e = 0.70
Grada e lageshtise	G = 0.90
Moduli i kompresionit oedometrik	E = 85 kg/cm ²
Kendi i ferkimit te brendshem	$\varphi = 19^\circ$
Kohezioni	C = 0.20 kg/cm ²
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	$\sigma = 1.80 \text{ kg/cm}^2$
Numri mesatar i goditjeve te SPT per 30cm	N _{spt} = 12-14

Shtresa Nr.3

Perfaqesohet nga; Suargjila te mesme deri ne suargjila te lehta zhavorore, jane me ngjyre bezhe ne kafe, jane me lageshtire deri me shume lageshtire. Permbajne shtresa te holla suargjilash, shtresa rere kokerr-vogel. Zajet e zhavorrit jane te rumbullakosura, me origjine ranorike dhe gelqerore. Jane mesatarisht te ngjeshura. Takohet ne thellesite: shiko prerjet gjeologjiko-litologjike.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja granulometrike

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	21.70 %
Fraksioni pluhuror	0.002-0.075 mm	26.40 %
Fraksioni rere	< 4.75 mm	16.80 %
Fraksioni Zhavoror	> 4.75mm	35.10 %

Plasticiteti

Kufiri i siperm i plasticitetit	Wrr = 32.70 %
Kufiri i poshtem i plasticitetit	Wp = 22.50 %
Numri i plasticitetit	Ip = 10.2
Lageshtia natyrore	Wn = 23.80 %

Address: Autostrada Tirane-Durres km 12, Picar Vore /

Contact: skender.allkja@alteageostudio.com; +355 68 20 74 332

ledio.allkja@alteageostudio.com; +355 68 33 36 767

NIPT: J62026003M | N.2101/11 | NZ.2101/7

www.alteageostudio.com

Pesha specifike	$\delta = 2.67 \text{ gr/cm}^3$
Pesha volumore ne gjendje natyrale	$\Delta = 2.09 \text{ gr/cm}^3$
Koeficienti i porozitetit	$e = 0.68$
Grada e lageshtise	$G = 0.90$
Moduli i kompresionit oedometrik	$E = 180 \text{ kg/cm}^2$
Kendi i ferkimit te brendshem	$\varphi = 30^\circ$
Kohezioni	$C = 0.18 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	$\sigma = 2.20 \text{ kg/cm}^2$
Numri mesatar i goditjeve te SPT per 30cm	$N_{\text{spt}} = 20-24$

Shtresa Nr.4

Perfaqesohet nga; Surera deri ne rera zhavorore me ngjyre bezhe ne gri, me shume lageshtire deri te ngopura me uje. Zajet e zhavorrit jane te rrumbullakosura, jane me perberje ranorike dhe karbonatike. Permbajne shtresa te holla suargjilash. Jane mesatarisht deri te ngjeshura. Takohet ne thellesite: shiko prerjet gjeologo-litologjike.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja granulometrike

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	9.20 %
Fraksioni pluhuror	0.002-0.075 mm	14.60 %
Fraksioni rere	< 4.75 mm	21.50 %
Fraksioni Zhavoror	> 4.75mm	54.70 %

Plasticiteti

Kufiri i siperm i plasticitetit	$W_{rr} = 28.70 \%$
Kufiri i poshtem i plasticitetit	$W_p = 22.30 \%$
Numri i plasticitetit	$I_p = 6.4$
Lageshtia natyrore	$W_n = 17.70 \%$
Pesha specifike	$\delta = 2.67 \text{ gr/cm}^3$
Pesha volumore ne gjendje natyrale	$\Delta = 2.15 \text{ gr/cm}^3$
Koeficienti i porozitetit	$e = 0.65$
Moduli i kompresionit oedometrik	$E = 150 \text{ kg/cm}^2$
Kendi i ferkimit te brendshem	$\varphi = 32^\circ$
Kohezioni	$C = 0.13 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	$\sigma = 2.40 \text{ kg/cm}^2$
Numri mesatar i goditjeve te SPT per 30cm	$N_{\text{spt}} = 28-32$

Shtresa Nr.5

Perfaqesohet nga; Argjilite, Alevrolite dhe Ranore, me ngjyre bezhe, gri. Jane me pak lageshtire, jane me çimentim te dobet deri me çimentim mesatar. Jane shume te ngjeshura. Takohet ne thellesine: shiko prerjet gjeologo-litologjike.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese te merren:

Perberja granulometrike

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	35.80 %
Fraksioni pluhuror	0.002-0.075 mm	37.40 %
Fraksioni rere	< 4.75 mm	22.60 %
Fraksioni Zhavoror	> 4.75 mm	4.20%

Plasticiteti

Kufiri i siperm i plasticitetit	$W_{rr} = 40.70\%$
Kufiri i poshtem i plasticitetit	$W_p = 21.40\%$
Numri i plasticitetit	$I_p = 19.3$
Lageshti natyrore	$W_n = 9.50\%$
Pesha volumore ne gjendje natyrale	$\Delta = 2.25 \text{ gr/cm}^3$
Kendi i ferkimit te brendshem	$\varphi = 29^\circ$
Kohezioni	$C = 0.46 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i kompresionit oedometrik	$E = 570 \text{ kg/cm}^2$
Rezistenca ne shtypje nje boshtore	$R_{sh} = 18.6 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	$\sigma = 2.80 \text{ kg/cm}^2$
Numri mesatar i goditjeve te SPT per 30cm	$N_{spt} = 50-70$

7. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Ne sheshin e ndertimit takohen depozitimet e Kuaternarit (Q_4al+el) qe perfaqesohen nga suargjila, surera, rera dhe zhavorre si dhe depozitimet Neogjenike qe perbehen nga argjilite, ranore dhe konglomerate.
2. Niveli i ujit nentokesor eshte (7.50m) nga siperfaqja e tokes. Ne dimer, ne periudhe me rreshje, niveli i ujit nentokesor ngrihet deri ne thellesine (2.50m). Jane ujra neutral dhe nuk jane agresive karshi hekurit dhe betonit.
3. Rekomandojme qe ne shtresen Nr.1 te mos mbeshteten themele te objektit.
4. Fenomene negative fiziko-gjeologjike ne sheshin e ndertimit qe te rrezikojne qendrueshmerine e objektit nuk jane konstatuar, por neqoftese nuk merrren masa inxhinierike keto fenomene krijohen dhe rrezikojne qendrueshmerine e objekteve qe jane ngjitur me kete shesh ndertimi.
5. Rekomandojme qe skarpatat e gropes te mbrohen nga te gjitha anet me masa inxhinierike qe mund te jene mure me pilota ose diafragma betoni.
6. Meqenese nga studimi i kryer shtresat gjeologjike jane ne formen e linzave qe paraqesin nje gjendje heterogjene, per te bere me homogjen kete shesh rekomandojme qe ne shesh te shtrohet nje shtrese zhavorri me trashesi 0.50-0.60 m dhe mbasi te jete ngjeshur kjo shtrese rekomandojme qe te filloje ndertimi i themeleve.
7. Rekomandojme qe ne rast se gjate hapjes se themeleve do te takohet ndonje shtrese me karakteristika te ndryshme me studimin e dhene duhet te merret mendimi i gjeologut dhe projektuesve per kalimn e situates.

8. LITERATURA DHE REFERENCAT E PERDORURA

1. Principi di geomeccanica. Autori Prof.Ing. Otello DEL GRECO, Prof.Ing. Mauro FORNARO.
2. Geotechnical Engineering. Author Renato Lancellota Department of structural Engineering, Technical University of Turin 2006.
3. Handbook of Geotechnical Investigation and Design Tables Author Burt Look Consulting Geotechnical Engineer Taylor & Francis 2006.
4. Geological Hazards Author Fred G. Bell Consulting Geotechnical Engineer Taylor & Francis 2006.

5. The Slop of Stability 2nd Edition Author E.N. Bromhead Consulting Geotechnical Engineer Taylor & Francis 2006.
6. Debris Flow Mechanis, Prediction and Countermeasures Author Tamotsu Takahashi Consulting Geotechnical Engineer Taylor & Francis 2006.
7. Foundation Design Codes and Soil Investigation Authors Yusuke Honjo; Osamu Kusakabe; Kenji Matsui; Masayuki kouda Gyaneswor Pokharel Taylor & Francis 2006
8. Foundation Engineering Handbook Design and Construction with the 2006 International Building Code edited 2006 by Robert W. Day.
9. Engineering Geology edited by F.G. Bell Second Edition 2007.
10. Engineering Geology (Principles and Practice) Edited and Compiled by M.H. de Freitas 2007.
11. Deep Excavation Theory and practice Chang –Yu Ou National Taiwan University of Science and Technology Taipei Taiwan 2009.
12. Experimental Rock Mechanics Kiyoo Mogi Profesor of university of Tokio 2009.
13. Expansive Soils Recent advances in characterization and Treatment edited by Amer Ali Al-Rawas & Mattheus F.A. Goosen University of Turabo, Puerto Rico USA 2009
14. Geotechnical Engineering of Dams; Robin Fell (University of New South Wales Australia), Patrick MacGregor Geologis, David Stapledon Geologist, Graeme Bell Consulting Dams Engineer 2009.
15. Soil Sampling and Method of analysis Edited by M.R. Carter & E.G. Gregorich Canadian Society of Soil Scence. Taylor & Francis Group. 2009.
16. Geotechnical and Environmental Aspects of Waste Disposal Sites R.W.Sarby (University of Wolverhampton, United Kingdom) & A.J.Felton (University of Wolverhampton, United Kingdom) 2009.
17. Rock Slope Engineering Civil and Mining Duncan C. Wyllie and Christopher W.Mah. Taylor & Francis 2009.
18. Foundation on rock Duncan C. Wyllie Principal, Golder Associates, Consulting Engineers Vancouver, Canada Taylor and Francis 2009.
19. Inxhinieria Sizmike. Prof. Doctor Niko Pojani Botimet Toena 2003.
20. Soil Improvement By Preloading Aris C. Stamatopoulos, Panaghiotis C. Kotzias 1985 A Wiley Interscience Publication.
21. Geotechnics of soft soil Focus on ground Improvement Minna Karstunen (University of Strathclyde, Gloagow, Scotland, UK) Martino Leoni (University of Stuttgart Stuttgart Germany) 2009.
22. Principles of Geotechnical Engineering Fifth Edition by Braja M, Das 2006.
23. Associazione Geotecnica Italiana (raccomandazioni sulla programmazione ed esecuzione delle indagini geotecniche).
24. Les essais in situ en mécanique des sols (Réalisation et interprétation) Maurice CASSAN Eyrolles Paris 1978.
25. MECANIQUE DES SOLS APLIQUEE aux travaux publics et au bâtiment. K Terzaghi, R.B. PECK. Dunod Paris 1961.
26. Prove geotecniche in sito. Cestari FERRUCIO 1990.
27. La mécanique des sols. J.VERDEYEN. V.ROISIN, J.NUYENS Dunod. Paris 1980.
28. Soil Mechanics: Concepts and Applications William Powrie Professor of Geotechnical Engineering, University of Southampton, Hinfield. Southampton SO17 1BJ E & SPON London 1996

29. Fondation et Ouvrages en Terre Gérard PHILIPPONNAT Editions Eyrolles 61 Boulevard Saint-Germain, 7005 Paris 1979.
30. Raporte gjeologjike per studimet e objekteve te veçante me lartesi 2-10 kate ne zonen prane qendres se Tiranës dhe ne zonen e Sheshit "Avni Rustemi". Kryer nga "A.I.t.e.a & Geostudio 2000" – 1995-Shtator 2022
31. British Standard (BS1377) 1990.
32. Code of Practice for Site Investigations (BS 5930:1999).
33. ASTM Standard 2017.
34. AASHTO Standard 2006.
35. Kushtet teknike te Projektimit KTP-78 Libri i I KTP-5-78.
36. International Building Code 2006.

Aneksi 01. Foto nga puna ne terren

BH-1

Foto nr.1 Pozicioni i sondes gjate kryerjes se shpimit BH-1



Foto nr.2 Kampionet e marra nga sonda BH-1; thellesia (0.00-5.00) m



Foto nr.3 Kampionet e marra nga sonda BH-1; thellesia (5.00-10.00) m



Foto nr.4 Kampionet e marra nga sonda BH-1; thellesia (10.00-15.00) m



Foto nr.5 Kampionet e marra nga sonda BH-1; thellesia (15.00-20.00) m

BH-2

Foto nr.6 Pozicioni i sondes gjate kryerjes se shpimit BH-2



Foto nr.7 Kampionet e marra nga sonda BH-2; thellesia (0.00-5.00) m



Foto nr.8 Kampionet e marra nga sonda BH-2; thellesia (5.00-10.00) m



Foto nr.9 Kampionet e marra nga sonda BH-2; thellesia (10.00-15.00) m

BH-3

Foto nr.10 Pozicioni i sondes gjate kryerjes se shpimit BH-3



Foto nr.11 Kampionet e marra nga sonda BH-3; thellesia (0.00-5.00) m



Foto nr.12 Kampionet e marra nga sonda BH-3; thellesia (5.00-10.00) m



Foto nr.13 Kampionet e marra nga sonda BH-3; thellesia (10.00-15.00) m

Aneksi 02. Vizatimet


PLANIMETRIA E PUNIMEVE GJEOLOGJIKE

Legend

- Prerje gjeologjike
- Sonde shpimi



**“REHABILITIM I FASADAVE DHE RRUGËS LUIGJ GURAKUQI DERI
TE SHESHI AVNI RUSTEMI (ME PARKIM DY KATE NËN TOKË)”**




LEGJENDA:







- PROJEKTI I PROPOZUAR
- PROJEKSIONI I PARKIMIT NENTOKESOR (THELLESIA 8M)

— RRUGA EKZISTUESE

Profili Gjeologo-Litologjik I-I
Shkalla horizontale 1:100
Shkalla vertikale 1:100




SHPJEGUES







-  Mbushje dheu dhe zhavorre kryer nga veprimtaria e njeriut. Mbetje inerte te materialeve te ndertimit suargjila dhe surera ne ngjyre kafe ne gri. Jane pak te ngjeshura.
 -  Suargjila te nesne deri te lehta ngjyre bezhe ne kafe te kuqerrente, ne lageshitre, plastike. Përmbajne shtresa te holla rere, surere dhe guricika te vogla. Jane nesatarisht te ngjeshura.
 -  Suargjila te nesne deri ne suargjila te lehta zhavorrore, jane ne ngjyre bezhe ne kafe, jane ne lageshitre deri ne shume lageshitre. Përmbajne shtresa te holla suargjilash, shtresa rere kokerr-vogel. Zajet e zhavorrit jane te rrumbullakosura, ne origjine ranorike dhe gelqerore. Jane nesatarisht te ngjeshura.
 -  Surera deri ne rera zhavorrore ne ngjyre bezhe ne gri, ne shume lageshitre deri te ngopura ne uje. Zajet e zhavorrit jane te rrumbullakosura, jane ne perberje ranorike dhe karbonatike. Përmbajne shtresa te holla suargjilash. Jane nesatarisht deri te ngjeshura.
 -  Argjilite, Alevrolite dhe Ranore, ne ngjyre bezhe, gri. Jane ne pak lageshiti, jane ne çimentin te dabot deri ne çimentin nesatar. Jane shume te ngjeshura.
-  Niveli i ujit nentokesor.

ALTEA GEOSTUDIO	SHKALLA	H 1:100	Nr.
		V 1:100	I-I
Objekti:	Gjeolog	Ing. Skender ALLKJA	
"Rehabilitim i fasades dhe rruges "Liqin Gurakuq" deri ne shehin "Avni Rostom", (me 2 kate parkim nentoke). Tirane.	Gjeolog	Ing. Besian KHAGOLLI	
	Gjeoteknike	Ing. Ardita MALAJ	
Porosites:	"BASHKIA TIRANE"	ALTEA&GEOSTUDIO 2000	2022

Profili Gjeologjiko-Litologjik II-II
 Shkalla horizontale 1:100
 Shkalla vertikale 1:100




SHPJEGUES







-  Moshje dhe zhavorre kryer nga veprimtaria e njeriut. Mbetje inerte te materialeve te ndertimit suargjila dhe surera ne ngjyre kafe ne gri. Jane pak te ngjeshura.
 -  Suargjila te nesne deri te lehta ngjyre bezhe ne kafe te kuqerrente, ne lageshtire, plastike. Përmbajne shtresa te holla rere, surere dhe guricka te vogla. Jane nesatarisht te ngjeshura.
 -  Suargjila te nesne deri ne suargjila te lehta zhavorore, jane ne ngjyre bezhe ne kafe, jane ne lageshtire deri ne shume lageshtire. Përmbajne shtresa te holla suargjilash, shtresa rere kokerr-vogel. Zafet e zhavorrit jane te rrumbullakosura, ne origjine ranarike dhe gelqerore. Jane nesatarisht te ngjeshura.
 -  Surera deri ne rera zhavorrore ne ngjyre bezhe ne gri, ne shume lageshtire deri te ngopura ne uje. Zafet e zhavorrit jane te rrumbullakosura, jane ne perberje ranarike dhe karbonatike. Përmbajne shtresa te holla suargjilash. Jane nesatarisht deri te ngjeshura.
 -  Argjilite, Alevrolite dhe Ranore, ne ngjyre bezhe, gri. Jane ne pak lageshti, jane ne qentim te dobët deri ne qentim nesatar. Jane shume te ngjeshura.
-  Niveli i ujit nentokesor.

ALTEA GEOSTUDIO	SHKALLA	H 1:100	Nr.
		V 1:100	II-II
Objekti:	Gjeolog	Ing. Skender ALLKJA	
Rihabilitim i fasades dhe rruges "Liqin Gurandeg" deri ne shkelqim "Avis Rentacar", (me 2 kate parkim nentokësor), Tirane.	Gjeolog	Ing. Besian XHAGOLLI	
	Gjeoteknikë	Ing. Ardieta MALAJ	
Porositës:	"BASHKIA TIRANE"	ALTEA&GEOSTUDIO 2000	2022

Profili Gjeologo-Litologjik III-III
 Shkalla horizontale 1:100
 Shkalla vertikale 1:100



SHPJEGUES

-  Mbushje dhe zhavorre kryer nga veprimtaria e njeriut. Mbetje inerte te materialeve te ndertimit suargjlla dhe surera ne ngjyre kafe ne gri. Jone pak te ngjeshura.
 -  Suargjlla te nesne deri te lehta ngjyre bezhe ne kafe te kuqerrenze, ne lageshire, plastike. Përmbajne shtresa te holla rere, surere dhe guricka te vogla. Jone nesatarisht te ngjeshura.
 -  Suargjlla te nesne deri ne suargjlla te lehta zhavorore, jone ne ngjyre bezhe ne kafe, jone ne lageshire deri ne shume lageshire. Përmbajne shtresa te holla suargjllash, shtresa rere kokerr-vogel. Zajet e zhavorrit jone te rrumbullakosura, ne origjine ranorike dhe gelqerore. Jone nesatarisht te ngjeshura.
 -  Surera deri ne rera zhavorore ne ngjyre bezhe ne gri, ne shume lageshire deri te ngopura ne uje. Zajet e zhavorrit jone te rrumbullakosura, jone ne perberje ranorike dhe karbonatike. Përmbajne shtresa te holla suargjllash. Jone nesatarisht deri te ngjeshura.
 -  Argjilte, Alevrolite dhe Ranore, ne ngjyre bezhe, gri. Jone ne pak lageshiti, jone ne çimentin te dobet deri ne çimentin nesatar. Jone shume te ngjeshura.
-  Niveli i ujit nentokesor.

ALTEA GEOSTUDIO	SHKALLA	H 1:100	Nr.
		V 1:100	III-III
Objekti:	Gjeolog	Ing. Skender ALLKJA	
"Rishikimi i fashës dhe rrethës "Liqim Gjeologjik" dritë në shkollën "Avni Rustemi", (në 2 kate parkim nentokësor), Tiranë.	Gjeolog	Ing. Besian XIHAGOLLI	
	Gjeoteknike	Ing. Ardita MALAJ	
Porositës:	"BASHKIA TIRANË"	ALTEA GEOSTUDIO 2000	2022

ALTEA GeOSTUDIO

GEOLOGICAL INVESTIGATIONS, GEOTECHNICAL & GEOPHYSICAL STUDIES,
LABORATORY TESTING FOR GEOTECHNICAL & CONSTRUCTION MATERIALS

INVESTIGIME GEOLOGJIKE, STUDIME GJEOTEKNIKE & GJEOFIZIKE, LABORATOR
PER KRYERJEN E PROVAVE TE MATERIALEVE TE NDERTIMIT & STUDIMEVE GJEOTEKNIKE

STUDIM INXHINIERO-SIZMOLOGJIK I SHESHIT TE NDERTIMIT PER PROJEKTIN “REHABILITIM I FASADAVE DHE RRUGES “LUIGJ GURAKUQI” DERI NE SHESHIN “AVNI RUSTEMI” (ME PARKIM DY KATE NENTOKE), NE TIRANE (804)

Address: Autostrada Tirane-Durres km 12, Picar Vore
Contact: skender.allkja@alteageostudio.com; +355 68 20 74 332
ledio.allkja@alteageostudio.com; +355 68 33 36 767
NIPT: J62026003M | LT 067110321
www.alteageostudio.com

Autor:

Shyqyri Aliaj

Skender Allkja

Besian Xhagolli

Porosites:

"BASHKIA TIRANE"

Tirane, 05/11/2022

PERMBAJTJA

1.	HYRJE.....	4
2.	KUADRI GJEOLIGO-TEKTONIK NE ZONEN RRETH ZONE SE TIRANES.....	4
3.	AKTIVITETI SIZMIK I ZONES SE TIRANES DHE ZONES PERRETH.....	5
4.	MODELI GJEOTEKNIK I SHESHIT TE NDERTIMIT.....	6
4.1	Klasifikimi i Truallit te Sheshit te Ndertimit.....	6
5.	VLERESIMI PROBABILITAR I RREZIKUT SIZMIK I SHESHIT TE NDERTIMIT NE KUSHTE SHKEMBORE TE TRUALLIT.....	8
6.	VLERESIMI I RREZIKUT SIZMIK TE SHESHIT TE NDERTIMIT NE KUSHTET KONKRETE TE TRUALLIT ME ANEN E PROGRAMIT KOMPJUTERIK "SHAKE 2000".....	8
6.1	Reagimi Dinamik i Modelit Gjeoteknik te Sheshit te Ndertimit.....	8
6.2	Nxitimi Maksimal (PGA_{max}) dhe Faktori i Amplifikimit Dinamik te Truallit (FA).....	10
6.3	Spektrat e Reagimit te Nxitimit te Lekundjeve te Forta.....	10
6.4	Periodat e Vibrimit te Truallit.....	12
7.	SPEKTRAT E PROJEKTIMIT.....	12
7.1	Spektri i Projektimit Sipas Kodit Shqiptar te Projektimit KTP N.2-89.....	12
7.2	Spektri i Projektimit Sipas Eurokodit 8.....	14
8.	PERFUNDIME.....	16
9.	LITERATURA.....	16
10.	RAPORT SIZMIK ME METODEN E MASW.....	18
10.1	Hyrje.....	18
11.	MASW.....	19
12.	PERPUNIMI I MATJEVE.....	21
12.1	PROFILI MASW.....	21
13.	INTERPRETIMI I PERFUNDIMEVE.....	26
14.	REFERENCA.....	26

Lista e figurave

<i>Figura 1 Profili gjeologjik Durres-Mali i Dajtit (Aliaj, 2000)</i>	4
<i>Figura 2 Shkëputjet aktive që përcaktojnë skenarin e rrezikut sizmik përRajonin Tiranë-Durrës [Aliaj, 2000].</i>	5
<i>Figura 3 Spektri i reagimit te nxitimit ne nivelin e shtreses 1 ne sipërfaqe te sheshit te ndertimit per periode perseritje 95 vjet, llogaritur per te 6 funksionet hyres dhe vleren mesatare te tyre.</i>	11
<i>Figura 4 Spektri i reagimit te nxitimit ne nivelin e shtreses 1 ne sipërfaqe te sheshit te ndertimit per periode perseritje 475 vjet, llogaritur per te 6 funksionet hyres dhe vleren mesatare te tyre.</i>	12
<i>Figura 5 Koeficienti dinamik β per kategori te ndryshme trualli</i>	13

Lista e tabelave

<i>Tabela 1 Vlerat e llogaritura te parametrave kryesore te rrezikut sizmik te sheshit te ndertimit per periode perseritje 95 dhe 475 vjet, ne truall shkembor.</i>	8
<i>Tabela 2 Vlerat e akseleracionit maksimal – Amax, dhe te faktorit te amplifikimit te truallit - FA ne sheshin e ndertimit per probabilitet 10 % / 10 vjet (ose 95 vjet periode perseritje te termetit)</i>	10
<i>Tabela 3 Vlerat e akseleracionit maksimal – Amax, dhe te faktorit te amplifikimit te truallit - FA ne sheshin e ndertimit per probabilitet 10 % / 50 vjet (ose 475 vjet periode perseritje te termetit)</i>	10
<i>Tabela 4 Vlerat e koeficientit te sizmicitetit - k_E</i>	13
<i>Tabela 5 Vlerat e parametrave qe percaktojne formen e kurbave te koeficientit dinamik β</i>	13

1. HYRJE

Me kerkesen e bere nga "**BASHKIA TIRANE**", kompania "**A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000**" kreu studimin inxhiniero-sizmologjik per "**Rehabilitimin e fasadave dhe rruges "Luigj Gurakuqi" deri ne sheshin "Avni Rustemi" (me parkim dy kate nentoke)**", ne Tirane.

Ky studim inxhiniero-sizmologjik u mbeshtet ne Punimin "Sizmiciteti, Sizmotektonika dhe Vleresimi i Rrezikut Sizmik ne Shqiperi" (Aliaj etj., 2010), te publikuar nga Akademia e Shkencave e Shqiperise, ne Raportin mbi kushtet gjeologo-inxhinierike te sheshit ne studim, Raportin Sizmik me metoden e valeve siperfaqesore te kryer nga Ing. Besian Xhagolli dhe Ing. Gjeolog Skender Allkja (2021) si dhe ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 1162, dt. 24.12.2020 "Per percaktimin e procedurave dhe afateve per pajisjen me vertetim per riskun e subjekteve, te cilat kerkojne te pajisen me leje zhvillimi / ndertimi" hyre ne fuqi dt. 24.03.2021 dhe ne materialin e pergatitur nga IGJEUM mbi vlerat e PGA sipas ndarjeve administrative. Ne kete studim eshte kryer vleresimi i rrezikut sizmik qe mund te kercenoje kete shesh ndertimi ne kushte truallit shkembor nepermjet nje metodologjie bashkekohore probabilitare Cornell-McGuire.

Vleresimi i rrezikut sizmik te sheshit ne studim ne kushtet specifike konkrete do te kryhet duke perdorur programin kompjuterik "SHAKE 2000" (G.A Ordonez, 2011, i perditësuar ne korrik 2016).

Rreziku sizmik eshte shprehur me ane te parametrave fizike te lekundjeve te truallit si pasoje e vibrimit te tij nga termetet, te tille si nxitimi maksimal PGA dhe nxitimet spektrale SA per periodat e lekundjes se truallit.

2. KUADRI GJEOLIGO-TEKTONIK NE ZONEN RRETH ZONE SE TIRANES

Qyteti i Tiranes ze vend ne Ultesiren Pran-Adriatike, pikerisht ne pjesen fushore me Jugore te sinklinalit molasik te Tiranes. Sinklinali i Tiranes, i gjate reth 80 km dhe i gjere 10-12 km, paraqet nje sinklinal asimetrik me krahu Perendimor me renie te forte deri te permbysur dhe krahu Lindor me renie te bute. Ndertohet nga depozitimet molasike te Miocenit te mesem-te siperm dhe pjeserisht te Pliocenit ne pjesen me veriore te tij.

Molasa Miocenike vendoset transgresivisht dhe me mosperputhje kendore mbi strukturat karbonatiko-flishore te Zonave Jonike dhe Krutane (shih Fig. 1).

Molasa Miocenike perbehet nga agjilite, alevrolite dhe ranore, ne bazen e Serravalianit edhe nga gelqerore lithotamnike.




Figura 1 Profili gjeologjik Durres-Mali i Dajtit (Aliaj, 2000)

Molasa Pliocenike ne Thumane dhe Mamurras vendoset transgresivisht dhe ne mospajtim kendor mbi strukturen e Zones se Krujes si dhe mbi molasen Miocenike te krahut Lindor te sinklinalit te Tiranes.

Nga qyteti i Tiranes drejt Veri-Perendimit, sinklinali i Tiranes zgjerohet dhe mbulohet me sediment aluviale Kuaternare, te cilat shtrihen Horizontalisht mbi sedimentet molasike Miocen-Pliocenike (Fig. 2). Sedimentet Kuaternare perfaqesohen me zhavorre te nderthurura me shtresa argjilash dhe ranash, qe jane rreth 15-20 m te trasha ne qytetin e Tiranes dhe drejt Veriut arrijne trashesine rreth 200 m prane lumit Mat.

Sinklinali i Tiranes nga Perendimi kufizohet me monoklinalin e Prezes nepermjet nje shkeputje aktive te tipit kundrahijpe. Drejt Lindjes zhvishen depozitimet flishore Oligocenike dhe me tej ato karbonatiko-flishore qe ndertojne antiklinalin e Dajtit (Zona e Krujes).

Antiklinali i Dajtit paraqitet ne formen e nje strukture lineare izoklinale, te komplikuar me nje shkeputje aktive te tipit mbihipje ne krahun perendimor te saj (Aliaj, 1996; shih Fig. 1, Fig. 2).




Figura 2 Shkëputjet aktive që përcaktojnë skenarin e rrezikut sizmik për Rajonin Tiranë-Durrës [Aliaj, 2000].

Qyteti i Tiranes ze vend ne pjesen me Jug-Lindore fushore, 100-140 m mbi nivelin e detit. Nga Lindja, Jugu dhe Perendimi, fusha e Tiranes kufizohet me kodra te uleta, te ndertuara nga sedimente te molases Miocenike. Kjo fushe qe i mbivendoset sinklinalit te Tiranes paraqet nje strukture te ngjashme me grabenet, e cila kufizohet nga Perendimi me kundrahijpen e Prezes dhe nga Lindja me mbihipjen e Dajtit (Aliaj etj., 2001).

Pikerisht ketu ze vend sheshi ne studim, ku do te ngrihet objekti ne Tirane. Sinklinali molasik i Tiranes qe shtrihet nen depozitimet Kuaternare eshte i mberthyer si ne morse nga te dy anet nepermjet te shkeputjeve aktive mihipese (shih Fig. 2). Keto shkeputje aktive jane shkaktare te gjenerimit te termeteve te fuqishem qe kane goditur e mund te godasin ne te ardhmen zonen ne afersi te sheshit te ndertimit.

Shkeputjet shtypese jane aktive deri ne ditet tona, çka deshmohet nga termetet e gjeneruar prej tyre. Nga zona e shkeputjeve te Tiranes jane regjistruar termete me magnitude deri 5.7 shkalla Rihter dhe intensitet epiqendror deri VII1/2-VIII balle shkalla MSK-64 (Aliaj, 1967)

3. AKTIVITETI SIZMIK I ZONES SE TIRANES DHE ZONES PERRETH

Termeti me i forte qe ka goditur qytetin e Tiranes eshte ai i 26.11.2019 me Ms = 6.4 dhe intensitet epiqendror I₀ = 9 balle MSK-64.


Nga shkeputjet sizmo-aktive qe rrethojne zonen e qytetit te Tiranes jane gjeneruar shume termete, ku me te fuqishmit nder ta jane: Termeti i 1617 me I₀ = 8 ballle MSK-64 ne Kruje,

26.8.1852 me $I_0 = 8$ balle ne Kepin e Rodonit, 16.5.1860 me $I_0 = 8$ balle ne Uren e Beshirit, 4.2.1834 me $M_s = 5.6$ ne Ndroq, 19.8.1970 me $M_s = 5.5$ ne Vrap, 16.9.1975 me $M_s = 5.3$ ne Kepin e Rodonit, 22.11. 1985 me $M_s = 5.5$ ne Gjirin e Drinit, dhe 9.1.1988 me $M_s = 5.4$ ne Tirane.

Tirana eshte prekur nga termete me intensitet 7-8 balle MSK-64 dhe me magnitude deri $M_s = 5.7$ (Aliaj, 1997). Nga pikepamja sizmo-tektonike, qyteti i Tiranes mund te preket ne te ardhmen nga termete me $M_{max} = 5.5$ deri 5.9 (Aliaj, 1997), dhe sipas hartes te termeteve maksimale te mundshem, Tirana perfshihet ne zonen me $M_{max} = 5.8 - 6.4$ ose $M_{max} = 6.1 \pm 0.3$ (Kociaj, 1986).

4. MODEL I GJEOTEKNIK I SHESHIT TE NDERTIMIT

Nga modeli gjeoteknik i percaktuar nga studimi gjeologo-inxhinierik, rezulton se ne sheshin e ndertimit, jane ndeshur depozitime Kuaternare deluviale dhe aluviale ndersa depozitimet e Neogjenit mund te takohen ne thellesi rreth 17.00m, sipas prerjes gjeologo-inxhinierike te meposhtme:



Shpejtesia mesatare e valeve terthore per prerjen e trojeve dherore, te vendosur mbi shkembinjte rrenjesore, eshte llogaritur nga matjet sizmike ne terren MASW.

Shpejtesia mesatare e pakos se depozitimeve dherore te vendosura mbi shkembinjte rrenjesore eshte: $V_{s,17} = 243$ m/sek dhe $V_{s30} = 346$ m/sek.

4.1 Klasifikimi i Truallit te Sheshit te Ndertimit

Sheshi i ndertimit, nga pikepamja e shtresave qe e ndertojne ate, klasifikohet truall i kategorise II-te sipas Kodit Shqiptar te Projektimit KTP-N.2-89, dhe ne baze te shpejtesise mesatare te valeve terthore per gjithe prerjen $V_{s30}=346$ m/s klasifikohet truall i klases "C" sipas Eurokodit 8 (EC-8, 2003).

KATEGORIA E TRUALLIT	PERSHKRIMI LITOLOGJIK DHE HIDROGJEOLGJIK
I	a. Formacione shkembore: magmatike, sedimentare (konglomerate, ranore me cimentim karbonatik dhe silicor, gelqerore, dolomite) dhe te serise efuzivo-sedimentare (diabaze, rreshpe te kuq, rreshpe silicore etj), te forta, te paaksidentuara nga tektonika, karsti dhe proceset e tjetersimit. b. Formacione flishore dhe te serise rreshpore me fortesi mesatare te paaksidentuara nga tektonika dhe tjetersimi (nderthurje argjilite alevrolite, ranore e rreshpe, gipse, konglomerate; ranore me cimentim argjilor, gipsor e argjilo-ranor).
II	a. Formacione shkembore me cashmeri shume te zhvilluar dhe shume te tjetersuar. b. Formacione zallishtore suargjilore te ngjeshura ose mesatarisht te ngjeshura, pavaresisht nga lageshtia. c. Formacione te shkrfeta: 1. Surera, suargjila e argjila me ose pa permbajtje te materialit coprizor, ne gjendje plastike dhe elastike te forte me lageshti. 2. Rera e zhavorre te ngjeshura dhe mesatarisht te ngjeshura me lageshti.
III	a. Formacione te shkrfeta: 1. Rera kokerrtrashe, kokerrmesme dhe kokerrimet, rera pluhurore me nivel uji prane siperfaqes; 2. Argjila dhe suargjila plastike te buta deri rrjedhese.

Klasifikimi i truallit sipas Kodit Shqiptar te Projektimit KTP-N.2-89

Tipi I truallit	Pershkrim I profilin stratigrafik	Parametrat		
		Vs30 (m/s)	NSPT (goditje/30cm)	cu (kPa)
A	Shkemb ose formacion tjetër gjeologjik I ngjashem me shkemb, duke perfshire te shumten 5m material me te dobet ne siperfaqe	>800	-	-
B	Depozitime me rere shume te ngjeshur, zhavorr ose argjile shume te ngurte, te pakten me deri disa dhjetra metra trashesi, te karakterizuara nga nje rritje graduale e vetive mekanike, me rritjen e thellesise.	360-800	>50	>250
C	Depozitime te thella me rere te ngjeshur ose gjysme te ngjeshur, zhavorr ose argjile e ngurte, me trashesi nga disa dhjetra metra ne disa qindra metra.	180-360	15-50	70-250
D	Depozitime dherash te palidhur deri gjysem te palidhur (me ose pa disa shtresa te buta lidhese kohezive), ose depozitime dherash qe ne masen mbizoteruese jane te buta (te dobeta) deri ne te forta, te lidhura.	100-180	<15	<70
E	Nje profil dheu qe ka nje shtrese siperfaqesore aluvionesh me vlera vs te tipit C dhe D dhe trashesi qe ndryshon nga 5m deri ne 20m, e vendosur mbi nje material te ngurte mbeshtetes me Vs>800 m/sek.			
S1	Depozitime qe kane ose permbajne nje shtrese prej te pakten 10m trashesi me argjila/lymra te buta me tregues te larte plasticiteti dhe nivel te larte ujerash nentokesore.	<100	-	10-20
S2	Depozitime dherash te lengezueshme, argjilash te ndjeshme ose cdo profil tjetër qe nuk perfshihet ne tipat A-E			

Klasifikimi i truallit sipas Eurokodit 8

5. VLERESIMI PROBABILITAR I RREZIKUT SIZMIK I SHESHIT TE NDERTIMIT NE KUSHTE SHKEMBORE TE TRUALLIT

Vleresimi i rrezikut sizmik te sheshit te ndertimit eshte kryer me metoden probabilitare Cornell-McGuire. Vlerat e shpejtimit maksimal te truallit - PGA jane llogaritur per truall shkembor, per nivel probabiliteti: 10 % probabilitet tejkalimi ne 50 vjet dhe 10% probabilitet tejkalimi ne 10 vjet (koha e ekspozimit dhe e jetegjatesise ekonomike), qe i korespondon periodave te perseritjes te termetit: 95 dhe 475 vjet, ne perputhje te plote me Eurokodin 8. Keshtu, nga llogaritjet e rrezikut sizmik, ku ze vend sheshi i ndertimit ne shqyrtim, vlerat e PGA jane 0.144 g per kushte trualli shkembor dhe per probabilitet 10%/10 vjet dhe 0.293 g per probabilitet 10%/50 vjet.

Rezultatet e rrezikut sizmik per probabilitet 10%/50 vjet ne kushte trualli shkembor per zonen e Tiranës jane permblodhur ne Tabelen 1.

Tabela 1 Vlerat e llogaritura te parametrave kryesore te rrezikut sizmik te sheshit te ndertimit per periode perseritje 95 dhe 475 vjet, ne truall shkembor.

Perioda e perseritjes	PGA
95 vite	0.144 g
475 vite	0.293 g

Sheshi i ndertimit ze vend ne treven e jashtme me regjim ne shtypje me $M_s\text{-max} = 7.0$, te llogaritur me relacionin e shuarjes te Sadigh etj., 1997.

Vlerat e shpejtimit maksimal te truallit - PGA dhe te shpejtimit spektral - Sa per perioda 0.2-0.5 sekonda korespondojne energjise periudhe-shkurter, e cila do te kete efektin me te madh mbi strukturat periudhe-shkurter, ne ndertimet deri afer 7 kate te larte, ndertimet me te zakonshme sot ne Bote. Vlerat e shpejtimit spektral periudhe-gjate: 1.0 sek, 2.0 sek etj. paraqesin nivelin e lekundjes te truallit qe do te kete efektin me te madh ne strukturat me periudhe-gjata, ne ndertimet 10 kate te larte e me teper, ne urat etj.

6. VLERESIMI I RREZIKUT SIZMIK TE SHESHIT TE NDERTIMIT NE KUSHTET KONKRETE TE TRUALLIT ME ANEN E PROGRAMIT KOMPJUTERIK "SHAKE 2000"

6.1 Reagimi Dinamik i Modelit Gjeoteknik te Sheshit te Ndertimit

Per te studiuar sjelljen ndaj veprimit sizmik te modelit gjeoteknik te sheshit te ndertimit, u perdor programi kompjuterik "SHAKE2000" per analizen 1-dimensionale te problemeve gjeoteknike te inxhinierise se termeteve (Gustavo A. Ordonez, Korrik 2011, i perditesuar Prill 2013).

Perzgjedhja e regjistrimeve te serive kohore te akseleracionit te termeteve per t'u aplikuar si funksione hyres ne programin "SHAKE2000" behet ne bazen e te dhenave PEER te regjistrimit te lekundjeve te forta.

Baza e te dhenave PEER te regjistrimit te lekundjeve te forta ka mundesi te gjera per kerkimin e completeve te regjistrimeve te serive kohorete akseleracionit te termeteve ne biblioteken e kesaj baze te dhenash, mbeshtetur ne:

- 1) Karakteristikat e regjistrimeve lidhur me M e termetit, tipin e shkeputjes gjeneruese, distancen dhe karakteristikat e sheshit te ndertimit,
- 2) (2) Ne formen e spektrit te reagimit te regjistrimeve ne krahasim me spektrin e sheshit te ndertimit, dhr
- 3) (3) Ne karakteristikat e tjera te regjistrimit (Technical Report for the PEER Ground Motion Database Web Application. Beta Version, October 1, 2010).

Nder kriteret me kryesore per kerkimin e regjistrimeve te duhura te serive kohore te akseleracionit jane M e termetit dhe tipi i shkeputjes qe ka gjeneruar ate termet. Keshtu ne rastin tone per vleresimin e rrezikut sizmik te sheshit te ndertimit ne Tirane, se pari jane zgjedhur regjistrime te termeteve te ceket te gjeneruar nga zona me regjim ne shtypje (nga shkeputje te tipit mbihipje ose lart-rreshqitje) dhe me magnitude afer 7.0, potenciali sizmik i treves se jashtme – i Shqiperise Perendimore me regjim ne shtypje, siç jane akselerogramat e termeteve te ndodhur ne Kaliforni - SHBA, Kanada, Armeni dhe Taivan.

Theksojme se ne rast te shesheve te ndertimit qe zene vend ne treven e brendshme – ne Shqiperine Lindore me regjim te sotem ne zgjerim duhen kerkuar e gjetur regjistrime te termeteve te gjeneruar nga zona me regjim ne zgjerim (nga shkeputje normale). Regjistrime te termeteve te gjeneruar nga shkeputje normale huazohen nga vende si Italia, Greqia, Maqedonia etj.

Ne perputhje me kriteret e lartpermendur si funksione hyres per sheshe ndertimi ne qytetin e Tiranës jane perzgjedhur akselerograma te termeteve nga Taivani, SHBA, Kanadaja, Armenia etj., te regjistruar ne shkembinj rrenjesore.

Te gjitha keto akselerograma jane shkallezuar per nivelin e PGA_{max} te sheshit te ndertimit ne shkembinj rrenjesore, per nje nivel te caktuar probabiliteti (ose per nje periode te dhene perseritje te termeteve).

Shkallezimi i regjistrimeve te bazes se te dhenave te lekundjeve te forta kryhet duke aplikuar nje faktor linear shumezimi qe nuk ndryshon permbajtjen e frekuences relative te serive kohore te akseleracionit. Ka dy opsione shkallezimi te regjistrimeve per te barazuar vlerat e tyre me spektrin e sheshit te ndertimit per nje seri periodash ose per nje periode te vetme. Ka edhe opsion te perdorimit te regjistrimeve te pashkallezuara.

Keshtu ne rastin e opsionit te shkallezimit te regjistrimeve per t'i barazuar me nje periode te vetme, psh me vleren e akseleracionit te nje sheshi ndertimi ne kushte trualli shkembor, faktori shumezues (f) llogaritet si vijon:

$$f = \frac{PGA_{shesh\ ndertimi}}{PGA_{regjistrim\ termeti}}$$

Opsioni i trete eshte marrja ne konsiderate vetem e regjistrimeve te pashkallezuara me $f = 1.0$. Me i thjeshte eshte perdorimi i regjistrimeve te pashkallezuara me faktor shumezues baraz me 1.0.

Ne rastin tone kemi perdorur regjistrime te shkallezuara te termeteve. Keshtu te gjitha akselerogramat e perdorur si funksione hyres jane shkallezuar = shumezuar (zvogeluar ose zmadhuar) me nje faktor te caktuar per tu barazuar me vlerat e $PGA = 0.144\ g$ dhe $0.293\ g$ qe paraqesin perkatesisht vlerat e rrezikut sizmik per probabilitet $10\%/10$ vjet dhe $10\%/50$ vjet ne shkembinj rrenjesore per sheshin e ndertimit ne shqyrtim.

Vlerat e akseleracionit maksimal, te llogaritura me programin kompjuterik "SHAKE2000" nga aplikimi si funksione hyres i termeteve te ndryshem, shumezohen me faktoret perkates shumezues – f per secilin termet, duke gjetur keshtu si akseleracionet maksimale – A_{max} , ashtu edhe faktoret e amplifikimit te truallit - FA ne thellesi te ndryshme te sheshit te ndertimit, dhe ne baze te tyre perlllogariten edhe vlerat e mesatarizuara te $A_{max-mes}$ dhe FA_{mes} , te paraqitura ne tabelat qe vijojne.

6.2 Nxitimi Maksimal (PGA_{max}) dhe Faktori i Amplifikimit Dinamik te Truallit (FA)

Nxitimet maksimale qe perfitohen ne tavanin e çdo shtrese te modelit gjeoteknik per te gjashte funksionet hyres te aplikuar ne shkembinjte rrenjesore ne thellesine 17.00 m, per nivel probabiliteti 10%/10 vjet dhe 10%/50 vjet jane paraqitur ne tabelat dhe figurat qe vijojne.

Tabela 2 Vlerat e akseleracionit maksimal – A_{max} , dhe te faktorit te amplifikimit te truallit - FA ne sheshin e ndertimit per probabilitet 10 % / 10 vjet (ose 95 vjet periode perseritje te termetit)

H (m)	NIIGATA_NI GH18NS	CHUETSU_ NGN007NS	CHUETSU_N IGH18NS	IWATE_IWT H15NS	CCHURCH_D FHSS73W	PGAav	AF
0.000	0.30417056	0.32063043	0.230803351	0.28963475	0.256693942	0.28038661	1.947129
-1.799	0.300132835	0.31575005	0.22888631	0.27733198	0.249805233	0.27438128	1.905426
-3.599	0.287212117	0.2980894	0.222397862	0.2413225	0.225445466	0.25489347	1.770094
-5.399	0.261792008	0.26486068	0.208002497	0.19108619	0.186669267	0.22248213	1.545015
-7.199	0.211955956	0.20890133	0.182006573	0.21192084	0.149950552	0.19294705	1.33991
-8.999	0.163643705	0.16349624	0.151488399	0.22968683	0.156572421	0.17297752	1.201233
-12.499	0.151242624	0.1559615	0.143061843	0.20942799	0.158018979	0.16354259	1.135712
-16.999	0.134291204	0.14622882	0.129151005	0.15944447	0.150884496	0.144	1

Amplifikimi me i madh ne siperfaqe te modelit gjeoteknik arrihet per termete te tipit NIIGATA_NIGH18NS me $A_{max} = 0.304$ g. Nxitimi maksimal mesatar ne siperfaqe te truallit eshte $A_{max-mes} = 0.280$ g dhe FA = 1.94.

Tabela 3 Vlerat e akseleracionit maksimal – A_{max} , dhe te faktorit te amplifikimit te truallit - FA ne sheshin e ndertimit per probabilitet 10 % / 50 vjet (ose 475 vjet periode perseritje te termetit)

H (m)	NIIGATA_NI GH18NS	CHUETSU_ NGN007NS	CHUETSU_N IGH18NS	IWATE_IWT H15NS	CCHURCH_D FHSS73W	PGAav	AF
0.000	0.668221545	0.62485945	0.568115386	0.56980219	0.534210637	0.59304184	2.024034
-1.799	0.660552212	0.61761744	0.564258229	0.5467717	0.521076061	0.58205513	1.986536
-3.599	0.633192261	0.58727747	0.547738801	0.47735412	0.469707275	0.54305399	1.853427
-5.399	0.589234164	0.51792736	0.506074757	0.37187268	0.378608646	0.47274352	1.613459
-7.199	0.476128373	0.38461367	0.419046946	0.46858274	0.299014016	0.40947715	1.397533
-8.999	0.264771907	0.35614042	0.3040182	0.48956657	0.337877967	0.35047501	1.19616
c	Studim/Vlerësim gjeologjiko-inxhinierik i trullit për objekte të mëdha H/C, porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.
d	Studim/Vlerësim gjeologjiko-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
e	Studime e projektme hidrogeologjike.
10	PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
a	Projektim centrale hidraulike (elektrik, primare, sekondare). Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).
b	Projektim centrale termike (primare, sekondare). Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).
c	Projektim impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era, etj.
d	Projektim nënstacione elektrike, primar sekondar – linja të tensionit të lartë.
e	Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.
11	PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR
a	Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.
b	Projektim sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.
c	Projektim sinjalistikë jondriçuese në aeroporte dhe heliporte.
d	Projektim sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.
12	STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/studio)
a	Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.
b	Studime/vlerësime gjeologjiko-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.
c	Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte, etj.
d	Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje të ndërtohen objekte komplekse si: hidrocentrale (për çdo fuqi të instaluar), termocentrale, porte, aeroporte, tunele për vepra hidroteknike, bazamente për ngarkesa të mëdha dhe objekte industriale.
e	Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkëfëta me mundësi lëngëzimi.
f	Studime të rrezikut sizmik në nivel rajonal (mikrozonieme sizmike) dhe në nivel kombëtar (hartat kombëtare të rrezikut sizmik).
13	Studime e projektme të ndërtimit dhe mbylljes së vendepozitimeve të mbetjeve të ngurta (urbane). Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).
14	Studime e projektme të ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

KATEGORITË NË FUSHAT E MBIQEQRJES DHE KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM

PUNIME TË PERGJITHSHME NDËRTIMI	
NP-1	Punime gërmimi në tokë.
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale.
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
NP-4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
NP-6 a	Diga të çdo lloji madhësie. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).
NP-6 b	Diga të vogla (diga me lartësi deri 10 m ose me vëllim uji të grumbulluar deri 1 milion m ³ ose gjatësi kurore dige deri 500 ml).
NP-6 c	Tunele hidroteknike.
NP-7 a	Ujësllës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
NP-7 b	Vepra naftësllës-gazsllës-vajsllës.
NP-8	Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.
NP-9	Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime.
NP-10	Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).
NP-11	Ndërtime për nënstacionet, kabinetat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit.
PUNIME SPECIALE NDËRTIMI	
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve.
NS-2	Impiante hidro-termosantare dhe mirëmbajtje e tyre.
NS-3	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).

NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
NS-5	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.
NS-6	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
NS-7	Barriera dhe mbrojtje rrugore.
NS-8 a	Ndërtime parafabrikat beton arme.
NS-8 b	Struktura metalike.
NS-8 c	Struktura druri.
NS-9	Punime strukturore speciale.
NS-10	Shtrësa dhe mbistruktura speciale.
NS-11	Punime mbi shina e traversa.
NS-12	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
NS-13	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
NS-14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.
NS-15	Pastrimi i ujërave detare, liqenor dhe lumor.
NS-16	Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).
NS-17	Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).
NS-18	Punime topogjeodezike.
NS-19	Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë.
NS-20	Shpime gjeologjiko-inxhinierike, puse e shpime për ujë.
NS-21	Impiante të trajtimit të ujërave të zeza. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).



POLICA E SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË CIVILE DHE E PRODUKTIT
CIVIL AND PRODUCT LIABILITY INSURANCE POLICY

000392/2022

Serial/ Serial	000392/2022
----------------	-------------

NIPTI	L21319037M	Dega/ Branch	TIRANE	Kodi/ Code	018	Data e Lëshimit/ Issued Date	03.06.2022
-------	------------	-----------------	--------	---------------	-----	---------------------------------	------------

Të dhënat e Agjentit / Agent details

Emër Mbiemër/ Name Surname	DEGA TIRANE	Adresa/ Address	TIRANE	Nr. Telefoni/ Phone No.	04 2263490
-------------------------------	-------------	--------------------	--------	----------------------------	------------

Periudha e Sigurimit / Insurance validity

Prej / From	04.06.2022	Deri / to	03.06.2023	Ora / Hour	00:00
-------------	------------	-----------	------------	------------	-------

Të dhënat e të Siguruarit / Insured details

Emri i plotë i të të siguruarit / Full name of the insured	ALTEA & GEO STUDIO 2000 shpk	Adresa/Telefoni Address/Phone	Autostrada Tiranë-Durrës, km 12 Picar, Vorë, Tiranë
Lloji i Biznesit / Type of business	Studime gjeoteknike qe kryen Altea & Geostudio 2000 shpk ne territorin e Shqiperise dhe ne Kosove	Nr. i Klientit/NIPT Customer No.	J62026003M

Të dhënat e përgjegjësive / Liability details

Përgjegjësi Civile / Civil Liability	PO	Përgjegjësi e Produktit / Product Liability	JO
---	----	--	----

Kufijtë e dëmshpërblimit për përgjegjësinë civile / Limit of indemnity for civil liability

Për çdo një ngjarje/ For any one occurrence	Dëme trupore/ Bodily injury	Dëme materiale/ Material damage	Kufiri total (agregat)/ Aggregate liability
200,000 EUR	100,000 EUR	100,000 EUR	5,000,000 EUR

Kufijtë e dëmshpërblimit për përgjegjësinë e produktit / Limit of indemnity for product liability

Për çdo një ngjarje/ For any one occurrence	Dëme trupore/ Bodily injury	Dëme materiale/ Material damage	Kufiri total/ Aggregate liability
---	---	---	---

Pjesa e zbritshme / Deductible sum

Pjesa e zbritshme në % Deductible Sum in %	10 % e vleres se demit,
---	-------------------------

Primi / Premium

Primi/ Premium	TAKSA/ TAX	Totali/ Total	Mënyra e pagesës/ Payment method	Data e pagesës/ Payment date
1,200	120	1,320 EUR	U.XH	15.06.2022

Perfituesi / Beneficiary	ALTEA & GEO STUDIO 2000 shpk
--------------------------	------------------------------

Nenshkrimi i polices se sigurimit, nenkupton qe I Siguruarit ka disponuar, kuptuar dhe pranuar te gjitha termat dhe kushtet e vecanta e te pergjitheshme te kesaj kontrate, si parakusht per marrjen e pergjegjesise nga Siguruesi.

I SIGURUARI/INSURED

ALTEA & GEO STUDIO 2000 shpk

(emër, mbiemër, firmë)



KUSHTET E PERGJITHSHME TE SIGURIMIT TE PERGJEGJESISE PROFESIONALE

Neni 1, Perkufizime

1. I Siguruarit është një person fizik ose juridik i regjistruar në Republikën e Shqipërisë.
2. "Demi" është dëmtimi trupor dhe pasuror i personit të siguruar.
3. Bisnesi për të cilin është lëshuar policja e sigurimit, në të cilën janë përfshirë edhe mbrojtjen e punonjësve të të siguruarit.
4. Me punonjës kuptojmë:
 - persona të punësuar me kontratë pune nga i Siguruarit ose
 - persona të marrë në punë provizorisht si zevendesues, nga i Siguruarit
5. Kjo policë mbulon përgjegjësinë vetëm në territorin e Shqipërisë.

Neni 2, Mbulimet e përfshira dhe dëmet personale

- a) Çdo drejtues ose partner të Siguruarit në cilësitë përkatëse të tij si i tillë.
- b) Çdo person të punësuar nga i Siguruarit sipas një kontrate shërbimi apo periudhë punësimi ose prove në cilësitë përkatëse të tij si i tillë.
- c) Çdo zyrtar ose punonjës i organizatave sportive shoqërore ose mbarëvajtje të Siguruarit ose të shërbimit në rast zjarri ose shërbimeve ambulatore në cilësinë përkatëse të tij.

Neni 3, Marrëveshjet Siguruese

Duke ju referuar kushteve, kufizimeve, përjashtimeve dhe konditave të tjera që përmban kjo policë dhe formulari, dhe me kusht që i Siguruarit të ketë paguar ose të ketë rënë dakord për të paguar primin i quajtur këtej e tutje "Sigurues" bie dakord të dëmshpërblejë të Siguruarin për:

1. Të gjitha shumat për të cilat i Siguruarit do të bëhet ligjërisht përgjegjës të paguar për kompensim, dhe kostot e dëmeve dhe shpenzimeve në lidhje me ndonjë ngjarje të siguruar për të cilën kjo policë zbatohet brenda limiteve të dëmshpërblimit të poshtë shënuara (deklarata), dhe në lidhje me biznesin sic është përshkruar në formular, përfshirë njësinë, e marrë me qera ose në pronësi të të Siguruarit.
2. Të gjitha shpenzimet për mosmarrëveshjet, të kryera me miratimin paraprak me shkrim të siguruesit në lidhje me ndonjë kërkesë dëmshpërblimi ndaj të Siguruarit, kërkesë për të cilën zbatohet dëmshpërblimi i shprehur në këtë policë.

Neni 4, Ngjarjet e Siguruar

Ngjarjet e mëposhtme janë të siguruar nga siguruesi në qoftë se ato ndodhin gjatë periudhës së sigurimit dhe kanë qenë raportuar të siguruesit nga ana e të Siguruarit, jo me vonë se nga data e përfundimit të mbulimit në sigurim dhe ai detyrohet të dëmshpërblejë të Siguruarin, për sa ai është civilisht përgjegjës me ligj, Dëmtime trupore (përfshirë vdekjen, sëmundjen ose plagosjen të/ose ndaj personave. Humbje ose dëmtime pasurore, të ndodhura gjatë Periudhës së Dëmshpërblimit, por përjashtuar përgjegjësia, duke ju bërë e ditur Siguruesit jo më vonë se 15 ditë mbas mbarimit të periudhës së dëmshpërblimit.

Neni 5, Limitet e Dëmshpërblimit

Limitet e shënuara në policë përfaqësojnë maksimumin që Siguruesi është i detyruar të paguajë për çdo dëmtim, dhe në asnjë rast ai nuk do të përgjigjet për shumën më të mëdha,

a) Për Çdo ngjarje

Përgjegjësia e siguruesit për të gjitha kostot e kompensimeve dhe shpenzimet e pagueshme çdo pretenduesi ose një numri pretenduesish për çdo ngjarje nuk do të kalojë shumën e përcaktuar në formular si limit i dëmshpërblimit për çdo ngjarje.

b) Klauzola të Serisë së dëmeve

Për të përcaktuar kufirin e përgjegjësisë së Siguruesit në lidhje me Ngjarjet e Siguruar ngjarjet e përcaktuara do të konsiderohen si një ngjarje dhe se kanë ndodhur gjatë periudhës së dëmshpërblimit në të cilën ka ndodhur dëmi i parë.

c) Limiti agregat

Përgjegjësia e Siguruesit për të gjitha kostot e kompensimeve dhe shpenzimet e pagueshme në lidhje me të gjitha ngjarjet e ndodhura gjatë çdo periudhe dëmshpërblimi nuk do të kalojë shumën e përcaktuar si limit agregat përmbledhës.

Neni 6

Kjo policë nuk do të zbatohet për:

Përgjegjësinë që i takon dëmtimeve trupore ose sëmundjeve të çdo personi sipas një kontrate punësimi ose marrje në provë me të Siguruarin nëse një përgjegjësi i tillë ka lidhje me dëmtimet trupore ose sëmundjeve që rrjedh prej/ose gjatë periudhës së punësimi.

1. Ndonje shpërblim profesional ose trajtim për shërbime të dhëna nga i Siguruarit por nuka janë marrë.
2. Përgjegjësinë për ndonjë humbje financiare që nuk rezultojn nga humbje pasurore ose dëmtime trupore
3. Çdo shërbim ose këshillë, ose trajtim profesional i dhënë, administruar ose neglizhuar nga i Siguruarit (dëmshpërblim profesional).
4. Përgjegjësia e çfarëdo lloj natyre që direkt ose indirekt shkaktohet nga/ose, ndikohet ose rrjedh prej ndotjes së ajrit, ujit ose tokës.
5. Përgjegjësia në lidhje me humbjen ose dëmtimin e pasurisë
 - a- që i përket të Siguruarit
 - b- përpunohet nga/ose është nën kujdesin, ruajtjen, kontrollin e të Siguruarit ose çdo personi të punësuar nga/ose që punon për të Siguruarin.
6. Përgjegjësia për humbje ose dëmtime të pasurisë që rrjedhin nga zjarri, rrufeja ose eksplozioni në njësinë e të Siguruarit.
7. Kërkesat për dëmshpërblim në lidhje me vonesën e realizimit ose plotësimin të kontratave që janë lidhur.
8. Përgjegjësia në lidhje me ndonjë artikull ose mall të furnizuar, instaluar, montuar nga i Siguruarit për qëllime aviacioni ose anijeve kozmike ose industrisë së automobilave (përfshirë ndonjë pjesë këmbimi dhe përbërëse).
9. Përgjegjësia në lidhje me ngjarje që janë rrjedhojë e një veprimi të pandershëm, të qëllimshëm ose neglizhencës së të Siguruarit dhe që duhej të parashikoheshin nga i Siguruarit duke pasur parasysh natyrën dhe rrethanat e këtij veprimi ose neglizhence.
10. Përgjegjësia marrë përsipër nga i Siguruarit sipas një kontrate ose ndonjë lloj tjetër marrëveshjeje, përveç rastit kur përgjegjësi i tilla do të jenë ngarkuar të Siguruarit edhe në mungesë të kontratave ose marrëveshjeve të tilla.

11. Çdo përgjegjësi e çfarëdo natyre që direkt ose indirekt është shkaktuar nga/ose, kontribuar nga/ose që rrjedh nga:
 - a- Rrezatimi ose ndotje jonizuese nga radioaktiviteti prej karburanteve bërthamore ose prej rrjedhjeve bërthamore ose djegja e karburanteve bërthamore.
 - b- Eksplozivitet toksike radioaktive ose lëndë të tjera të rrezikshme të përbërëve eksplozive bërthamore ose pjesëve përbërëse të tyre,
 - c- Asbestosi ose sëmundje të tjera që lidhen me të (përfshirë kancerin) që rrjedhin nga ekzistenca, prodhimi, trajtimi, përpunimi, shitja, shpërndarja, magazinimi, depozitimi ose përdorimi i asbestit, dhe/ose produkteve që përmbajnë asbest.

12. Përgjegjësia për çdo pasojë të luftës, pushtimit, veprimeve të armiqve të jashtëm (në luftë ose jo), lufta civile, revolucionin, ndërhyrja ushtarake, uzurpimi me fuqi terroriste, vandalizmi ose sabotimi.

13. Gjobat, masat ndëshkuese.

Neni 7, Pajesja e Primit

I Siguruarit është i detyruar të paguajë, tek Siguruesi ose tek qendra e agjencisë në të cilën është nënshkruar kontrata me skadencat përkatëse, të njëjtin prim të caktuar në kontratë.

Vjelja e primeve në vazhdimësi realizohet në vëndbanimin e të Siguruarit, ai nuk mundet në asnjë mënyrë të përjashtohet nga një detyrim i tillë.

Kësti i parë duhet të jetë paguar me dhënie e kontratës.

Këstet pasardhëse paguhet me dhënie e dëshmimeve të pagesave që duhet të mbajë datën e pagimit dhe firmën e personit që sigurohet.

Sigurimi hyn në fuqi në orën 24 të ditës së shënuar në policë, në se në këtë moment primi është paguar, në rast të kundërt hyn në fuqi në orën 24 të ditës së kryerjes së pagesës.

Primi mbetet i pezulluar në ditën e skadencës së caktuar në kontratë.

Për primet pasuese së pari është lejuar kufiri për tu respektuar prej 15 ditëve, gjatë të cilave sigurimi mbetet pezull, dhe rihyn në fuqi në orën 24 të ditës së pagimit të primit duke mbetur të pandryshuara skadencat e përcaktuara në kontratë.

Gjatë 15 ditëve të mësipërme, Siguruesi ka të drejtën të deklarojë me letër rekomandë, rizgjdhjen e kontratës, duke ndaluar të drejtën e primeve të skaduara dhe të kërkojë ekzekutimin ligjërisht.

Primi është gjithmonë vendimtar për periudhën e sigurimit prej një viti sepse zgjidh cështjet e kontratës.

Neni 8, Parashikimet dhe procedurat për kërkesat për dëmshpërblim

1. I Siguruarit do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe për të lehtësuar dëmtimet trupore, sëmundjet, humbjet ose dëmtimet pasurore, të cilat mund të shkaktojnë lindjen e një kërkesë për dëmshpërblim sipas kësaj policë.
2. Çdo ngjarje e cila do të sillte lindjen e një kërkesë për dëmshpërblim sipas policës, duhet të raportohet me shkrim Siguruesit sa më shpejt të jetë e mundur. Asnjë korrigjim ose riparim nuk do të bëhet për derisa Siguruesi të bëjë investigimin. I Siguruarit duhet të japë njoftim të menjëhershëm për çdo ndjekje penale për plagosje fatale ose procedura civile në lidhje me ngjarjen, dhe do të dërgojë menjëherë Siguruesit të gjitha dokumentat që kanë të bëjnë me cështjen.
3. Asnjë pranim i përgjegjësisë, premtim, ose pagesë nuk do të bëhet pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Siguruesi do të ketë të drejtën sipas zgjedhjes së tij, të marrë përsipër dhe të drejtojë në emër të Siguruarit mbrojtjen dhe rregullimin e çdo kërkesë për dëmshpërblim dhe të procedojë me shpenzimet dhe në të mirën e tij çdo pretendim për dëmshpërblim ose dëme ndaj çdo personi tjetër dhe i Siguruarit duhet të japë të gjithë informacionin dhe ndihmën e kërkuar.
4. Siguruesi mund të paguajë të Siguruarit shumën maksimale e pagueshme sipas kësaj policë në lidhje me çdo ngjarje ose çdo shumë më të vogël me të cilën mund të rregullohen pretendimet që lindin nga një ngjarje e tillë, dhe Siguruesi nuk do të ketë përgjegjësi të mëvonshme në lidhje me atë ngjarje, me përjashtim të pagesës së kostos dhe shpenzimeve të mosmarrëveshjeve të shkaktuara për pagesa të tilla.
5. Nëse në kohën e ndonjë ngjarje ose pretendimi për dëmshpërblim, ekziston një policë tjetër për dëmshpërblim ose sigurim në favor të/ose e ndikuar nga/ose në emër të Siguruarit, e zbatueshme në të tilla ngjarje, Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës sipas kësaj policë të dëmshpërblejë të Siguruarin në lidhje me këtë ngjarje ose pretendim, me përjashtim të pjesës që tejkalon shumën e cila do të ishte e pagueshme sipas dëmshpërblimit ose sigurimit tjetër sikur kjo policë të mos ishte në fuqi.

Neni 9, Te tjera

1. Kjo policë, shtojcat e poshtëshënuara, formulari dhe kushtet specifike do të lexohen së bashku si një kontratë, dhe çdo fjalë ose shprehje për të cilën është atribuar një kuptim i vecantë në çdo pjesë të kësaj policë, formularit ose kushteve të vecanta, do të mbajë po atë kuptim kudo që të shfaqet.
2. Nëse primi për këtë policë ka qenë kalkuluar sipas një vlerësimi të dhënë nga i Siguruarit, ky do të mbajë shënime të sakta për gjithë detajet përkatës dhe do të lejojë Siguruesin në çdo moment të arsyeshëm të kohës të inspektojë shënime të tilla dhe me mbarimin e çdo periudhe dëmshpërblimi, do të dërgojë Siguruesit gjëndjen e saktë të rregulluar kështu që për këtë periudhë do të kalkulohet primi dhe diferenca e paguar nga i Siguruarit si mbulim.
3. Siguruesi mundet në çdo kohë të arsyeshme të inspektojë çdo njësi dhe në rast të ndonjë difekti ose rreziku të paraqitur, Siguruesi mund të japë njoftim me shkrim të Siguruarit për rastet kur e gjithë përgjegjësia e siguruesit për arësye të difekteve dhe rreziqeve të tilla, do të pezullohet.
4. Nëse në një kohë të caktuar do të shfaqet materialisht dicka që do të ndikojë në rrezikun e siguruar, i Siguruarit duhet, brenda 7 ditëve të japë njoftim me shkrim Siguruesit.
5. Në rast se mosmarrëveshjet ndërmjet të Siguruarit dhe Siguruesin, nuk do të zgjidhen me mirekuptim midis paleve, ato të zgjidhen nga gjykata e cyteti ku është lëshuar policja e sigurimit.



POLICA E SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE
PROFESSIONAL LIABILITY INSURANCE POLICY

001580/2022

Seria/ Serial	001580/2022
----------------------	-------------

NIPTI	L21319037M	Dega/ Branch	TIRANE	Kodi/ Code	018	Data e Lëshimit/ Issued Date	03.06.2022
--------------	------------	---------------------	--------	-------------------	-----	-------------------------------------	------------

Të dhënat e Agjentit / Agent details

Emër Mbiemër/ Name Surname	DEGA TIRANE	Adresa/ Address	TIRANE	Nr. Telefoni/ Phone No.	04 2263490
-----------------------------------	-------------	------------------------	--------	--------------------------------	------------

Periudha e Sigurimit / Insurance validity

Prej / From	04.06.2022	Deri / to	03.06.2023	Ora / Hour	00:00
--------------------	------------	------------------	------------	-------------------	-------

Të dhënat e të Siguruarit / Insured details

Emri i plotë i të të siguruarit / Full name of the insured	ALTEA & GEO STUDIO 2000 shpk	Adresa/ Address	Autostrada Tiranë-Durrës, km 12 Picar, Vorë, Tiranë
Lloji i Biznesit / Type of business	Studime gjeoteknike qe kryen Altea & Geostudio 2000 shpk ne territorin e Shqiperise dhe ne Kosove	ID Klientit/NIPT Customer ID	J62026003M

Kufijtë e dëmshpërblimit / Limit of indemnity

Për çdo një ngjarje/ For any one occurrence	Dëme trupore/ Bodily injury	Dëme materiale/ Material damage	Kufiri total (agregat)/ Aggregate liability
200,000 EUR	100,000 EUR	100,000 EUR	5,000,000 EUR

Pjesa e zbritshme / Deductible sum

Pjesa e zbritshme / Deductible Sum	10 % e vleres se demit,
---	-------------------------

Primi / Premium

Prim/ Premium	TAKSE / TAX	Totali/ Total	Mënyra e pagesës/ Payment method	Data e pagesës/ Payment date
1,800	180	1,980 EUR	U.XH.	15.06.2022

Perfituesi / Beneficiary	ALTEA & GEO STUDIO 2000 shpk
---------------------------------	------------------------------

Nenshkrimi i polices se sigurimit, nenkupton qe I Siguruari ka disponuar, kuptuar dhe pranuar te gjitha termat dhe kushtet e vecanta e te pergjitheshme te kesaj kontrate, si parakusht per marrjen e pergjegjesise nga Siguruesi.

I SIGURUARI/INSURED

ALTEA & GEO STUDIO 2000 shpk

(emër, mbiemër, firmë)

Shenker

Adly



SIGURUESI/INSURER



(emër, mbiemër, firmë, vutë)

KUSHTET E PËRGJITHËSHME TË SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË PUBLIKE DHE PRODUKTI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kushtet e Përgjithëshme të kontratës së Sigurimit të Përgjegjesisë Publike dhe të Produktit, këtu më poshtë do të quhen shkurtimisht "Kushtet të Sigurimit".

Shoqëria e Sigurimeve "ANSIG", këtu më poshtë do të quhet "Siguruesi"

Personi fizik ose juridik, interesi i të cilit do të mbulohet në sigurim sipas katër kushteve të Përgjegjesisë Publike dhe të Produktit, këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "I Siguruar".

Kontrata për Sigurim e Përgjegjesisë Publike dhe të Produktit, lidhur midis Siguruesit dhe të Siguruarit, këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "Polica e Sigurimit".

SHTESË PERSONASH TË SIGURUAR

Nëse kërkohet nga i Siguruarit dhe është specifikuar në formular, fjala "I Siguruar" do të përfshijë:

- Çdo drejtues ose partner të Siguruarit në cilësitë përkatëse të tij si i tillë,
- Çdo person të punësuar nga I Siguruarit sipas një kontrate shërbimi apo periudhë punësimi ose prove në cilësitë përkatëse të tij si i tillë,
- Çdo zyrtar ose punonjës i organizatave sportive shoqërore ose mbarëvajtje të Siguruarit ose të shërbimit në rast zjarri ose shërbimeve ambulatore në cilësinë përkatëse të tij.

MARRËVESHJET SIGURUESE

Duke ju referuar kushteve, kufizimeve, përjashtimeve dhe konditave të tjera që përmban kjo police dhe formulari, dhe me kusht që i Siguruarit të ketë paguar ose të ketë rënë dakord për të paguar primin _____ i kujtimit këtej e tutje "Sigurues" bie dakord të dëmshpërblejë të Siguruarin për:

- Të gjitha shumtat për të cilat i Siguruarit do të bëhet ligjërisht përgjegjës të paguarë për kompensim, dhe kostot e dëmeve dhe shpenzimeve në lidhje me ndonjë ngjarje të siguaruar për të cilën kjo police zbatohet brenda limiteve të dëmshpërblimit të poshtë shënuara (deklarata), dhe në lidhje me biznesin sic është përshkruar në formular, përfshirë njësinë, e marrë me qera ose në pronësi të të Siguruarit.
- Të gjitha shpenzimet për mosmarëveshjet, të kryera me miratimin paraprak me shkrim të Siguruesit në lidhje me ndonjë kërkesë dëmshpërblimi ndaj të Siguruarit, kërkesë për të cilën zbatohet dëmshpërblimi i shprehur në këtë police.

Ngjarjet e Siguruara

Siguruesi ofron sigurimin e Përgjegjesisë Publike dhe detyrohet të dëmshpërblejë të Siguruarin, për sa ai është civilisht përgjegjës me ligji:

I. PËR PËRGJEGJËSINË PUBLIKE

- Dëmtime trupore (përfshirë vdekjen, sëmundjen ose plagosjen të/ose ndaj personave,
- Humbje ose dëmtime pasurore, të ndodhura gjatë periudhës së dëmshpërblimit, por përjashtuar përgjegjësia e produktit përshkruar këtu më poshtë dhe duke ju bërë e ditur Siguruesit jo më vonë se _____ vjet pas mbarimit të periudhës së dëmshpërblimit.

Limitet e Dëmshpërblimit

Limitet e shënuara në policë përfaqësojnë maksimumin që Siguruesi është i detyruar të paguarë për çdo dëmtim, dhe në asnjë rast ai nuk do të përgjigjet për shumta më të mëdha.

a) Për Çdo ngjarje

Përgjegjësia e siguruarit për të gjitha kostot e kompensimeve dhe shpenzimet e pagueshme çdo pretenduesi ose një numri pretenduesish për çdo ngjarje nuk do të kalojë shumën e përcaktuar në formular si limit i dëmshpërblimit për çdo ngjarje.

b) Klauzola të serisë së dëmeve

Për të përcaktuar kufirin e përgjegjesisë së Siguruesit në lidhje me ngjarjet e siguruaruar ngjarjet e përcaktuara më poshtë do të konsiderohen si një ngjarje dhe se kanë ndodhur gjatë periudhës së dëmshpërblimit në të cilën ka ndodhur dëmi i parë.

(Përgjegjësia Publike)

Gjithë dëmet e rrjedhura nga ekspozimi i vazhdueshëm e i përsëritur ndaj kushteve që në thelb përmbajnë të njëjtin shkallë rrezikshmërie.

Gjithë dëmet ndodhin gjatë periudhës së vlefshmërisë së sigurimit dhe rrjedhin

- ⇒ Nga i njëjti shkak, p.sh nga i njëjti gabim në projekt, prodhim instruksionet e përdorimit ose etiketim,
- ⇒ ose që i takojnë furnizimit të të njëjtave produkte apo produkteve që shfaqin të njëjtin difekt.

c) Limiti agregat

Përgjegjësia e Siguruesit për të gjitha kostot e kompensimeve dhe shpenzimet e pagueshme në lidhje me të gjitha ngjarjet e ndodhura gjatë çdo periudhe dëmshpërblimi nuk do të kalojë shumën e përcaktuar si limit agregat përmbledhës.

Kufizimet Territoriale

Territori i Policës është (vëndi ku është vendosur Siguruesi).

Polica i nënshtrohet ligjit/juridiksionit Shqiptar.

Përjashtime të përgjithëshme

Kjo police nuk do të zbatohet për:

- Përgjegjësia në q të takon dëmtimeve trupore ose sëmundjeve të çdo personi sipas një kontrate punësimi ose marrje në provë me të Siguruarin nëse një përgjegjësi e tillë ka lidhje me dëmtimet trupore ose sëmundjeve që rrjedh prej/ose gjatë periudhës së punësimit.
- Përgjegjësia në lidhje me:
 - Çdo mjet (ose rimorkio bashkuar me të) e licensuar për përdorim në rrugë publike ose mjet për të cilin kërkohet një sigurim i detyrueshëm nga legjislacioni i trafikut rrugor, nëse ky mjet është në pronësi, është marrë me qira, është ruajtur ose drejtohet nga I Siguruarit që përcaktohet në formular ose nga personi që kërkon dëmshpërblim.
 - Nga përdorimi i mjeteve motorrike, makinave ose pajisjeve të drejtuara ose të përdorura nga persona që nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç.
 - Ngarkimi ose shkarkimi nga/ose në mjet ose rimorkio.
- Përgjegjësia në lidhje me:
 - Anije ose Avion (përveç varkave me irema) që janë prodhuar ose kanë si destinacion lundrimin ose udhëtimin në ujë, ajër ose hapësirë, nëse kjo anije ose avion është në pronësi të, është marrë me qira ose huajtur ose trajtohet nga i Siguruarit.
 - Ngarkimi ose shkarkimi nga/ose në çdo lloj anije, mjete lundrues ose avioni.
- Përgjegjësia në lidhje me humbje financiare që nuk rezultojn nga humbje pasurore ose dëmtime trupore sic është përcaktuar në seksionin II (humbje tjeshit financiare).
- Çdo shërbim ose këshillë, ose trajtim profesional i dhënë, administruar ose neglizhuar nga i Siguruarit (dëmshpërblim profesional).
- Përgjegjësia e çfarëdo lloj natyre që direkt ose indirekt shkaktohet nga/ose, ndikohet ose rrjedh prej ndotjes së ajrit, ujit ose tokës.
- Përgjegjësia në lidhje me humbjen ose dëmtimin e pasurisë
 - që i përket të Siguruarit
 - përpunohet nga/ose është nën kujdesin, ruajtjen, kontrollin e të Siguruarit ose çdo personi të punësuar nga/ose që punon për të Siguruarin.
- Përgjegjësia për humbje ose dëmtime të pasurisë që rrjedhin nga zjari, rrufeja ose eksplozionin në njësinë e të Siguruarit.
- Kërkesat për dëmshpërblim në lidhje me vonesën e realizimit ose plotësimit të kontratave që janë lidhur.
- Pretendimet për dëmtime të punimeve ose mallrave të prodhuara ose furnizuar nga i Siguruarit (ose nga palët e treta sipas porosisë apo për llogari të tij), për shkaqe të brendëshme në fabrikimin ose furnizimin e tij.
- Përgjegjësia në lidhje me kthimin, rivendosjen, riparimin, montimin, ose koston e/ose zvogëlimin në vlerë të ndonjë malli ose mallrave të furnizuar, instaluar ose montuar nga i

Siguruarit nëse përgjegjësi të tilla rrjedhin nga ndonjë difekt i brendshëm ose nga natyra e dëmshme ose e papërshtatshme.

- Përgjegjësia në lidhje me ndonjë artikull ose mall të furnizuar, instaluar, montuar nga i Siguruarit për qëllime aviacioni ose anijeve kozmike ose industrisë së automobilave (përfshirë ndonjë pjesë këmbimi dhe përbërëse).
- Përgjegjësia në lidhje me ngjarje që janë rrjedhojë e një veprimi të pandershëm, të qëllimshëm ose neglizhencës së të Siguruarit dhe që duhet të parashikoheshin nga i Siguruarit duke pasur parasysh natyrën dhe rrethanat e këtij veprimi ose neglizhence.
- Përgjegjësia marrë përsipër nga i Siguruarit sipas një kontrate ose ndonjë lloj tjetër marëveshjeje, përveç rasti kur përgjegjësi të tilla do të jenë ngarkuar të Siguruarit edhe në mungesë të kontratave ose marëveshjeve të tilla.
- Çdo përgjegjësi e çfarëdo natyre që direkt ose indirekt është shkaktuar nga/ose, kontribuar nga/ose që rrjedh nga:
 - Rrezatimi ose ndotje jonizuese nga radioaktiviteti prej karburanteve bërthamore ose prej rrjedhjeve bërthamore ose djeçja e karburanteve bërthamore.
 - Ekspozitivet toksike radioaktive ose lëndë të tjera të rrezikshme të përbërjeve eksplozive bërthamore ose pjesëve përbërë të tyre.
 - Asbestosi ose sëmundjet të tjera që lidhen me të (përfshirë kancerin) që rrjedhin nga e zistenca, prodhimi, trajtimi, përpunimi, shpërndarja, magazinimi, depozitimi ose përdorimi i asbestit, dhe/ose produkteve që përmbajnë asbest.
- Përgjegjësia për çdo pasojë të luftës, pushtimit, veprimeve të armiqve të jashtëm (në luftë ose jo), lufta civile, revolucionin, ndërhyrja ushtarake, zuzurpimi me fuqi terroriste, vandalizmi ose sabotimi.
- Gjohat, masat ndëshkuese.

Pagesa e Primit

Pikënisja dhe Periudha e Sigurimit

I Siguruarit është i detyruar të paguar, tek Siguruesi ose tek qendra e agjensisë në të cilën është nënshkruar kontrata me skadencat përkatëse, të njëjtin prim të caktuar në kontratë. Vjelja e primeve në vazhdimësi realizohet në vëndbanimin e të Siguruarit, ai nuk mundet në asnjë mënyrë të përjashtohet nga një detyrim i tillë.

Kësti i parë duhet të jetë paguar me dënimin e kontratës.

Këset pasardhëse paguhen me dënimin e dëshmitave të pagesave që duhet të mbajë datën e pagimit dhe firmën e personit që sigurohet.

Sigurimi linn në fuqi në orën 24 të ditës së shënuar në policë, në se në këtë moment primi është paguar, në rast të kundërt linn në fuqi në orën 24 të ditës së kryerjes së pagësës.

Primi mbetet i pezulluar në ditën e skadencës së caktuar në kontratë.

Për primet pasuese së pari është lejuar kufiri për tu respektuar prej 15 ditëve, gjatë të cilave sigurimi mbetet pezull, dhe rihyn në fuqi në orën 24 të ditës së pagimit të primit duke mbetur të pandrysluara skadencat e përcaktuara në kontratë.

Gjatë 15 ditëve të mësipërme, Siguruesi ka të drejtën të deklarojë me letër rekomandë, rizgjdhjen e kontratës, duke ndaluar të drejtën e primeve të skaduara dhe të kërkojë ekzekutimin ligjërisht.

Nëse i siguarit nuk kryen në kohën e caktuar njoftimin e të dhënave të mësipërme ose pagimin e diferencës aktive të detyruar, Siguruesi mund të fiksogjë një afat të metejshëm jo më pak se 15 ditë, pas të cilit primi i parapaguar në mënyrë provizore për këset pasardhëse konsiderohet për llogari ose si garanci për atë periudhë sigurimi vjetore për të cilin nuk është aplikuar rregullimi ose pagimi i diferencës aktive dhe garancia mbetet e anuluar deri në orën 24 të ditës në të cilën i Siguruarit ka përmbushur detyrimin e tij, pa prekur të drejtën e shoqërisë për të vepruar juridikisht ose për të deklaruar, me letër rekomandë zgjidhjen e kontratës.

Për kontratat e skaduara në qoftë se i Siguruarit nuk plotëson detyrimin në lidhje me rregullimin e primit, Siguruesi duke ndaluar të drejtën e saj të veprimeve ligjërisht, nuk është e detyruar për dëme të ndodhura në periudhën të cilën i referohet mungesa e rregullimit.

Sa herë që sipas një rregullimi vjetor, bilanci i elementëve të ndryshueshëm të rrezikut tejkalon dyfishin e asaj që është marrë si bazë për përcaktimin

Parashikimet dhe procedurat për kërkesat për dëmshpërblim

- I Siguruarit do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe për të lehtësuar dëmtimet trupore, sëmundjet, humbjet ose dëmtimet pasurore, të cilat mund të shkaktojnë linden e një kërkesë për dëmshpërblim sipas kësaj police.
- Çdo ngjarje e cila do të sillte lindjen e një kërkesë për dëmshpërblim sipas policës, duhet ti raportohet me shkrim Siguruesit sa më shpejt të jetë e mundur. Asnjë korigjim ose riparim nuk do të bëhet për derisa Siguruesit të bëjë investigimin. I Siguruarit duhet të japë njoftim të menjëshëm për çdo ndjekje penale për plagosje fatale ose procedura civile në lidhje me ngjarjen, dhe do të dërgojë menjëherë Siguruesit të gjitha dokumentat që kanë të bëjnë me çështjen.
- Asnjë pranim i përgjegjesisë, premtim, ose pagesë nuk do të bëhet pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Siguruesi do të ketë të drejtën sipas zgjedhjes së tij, të marrë përsipër dhe të drejtojë në emër të Siguruarit mbrojtjen dhe rregullimin e çdo kërkesë për dëmshpërblim dhe të procedojë me shpenzimet dhe në të mirën e tij çdo pretendim për dëmshpërblim ose dëme ndaj çdo personi tjetër dhe i Siguruarit duhet të japë të gjithë informacionin dhe ndihmën e kërkuar.
- Siguruesi mund ti paguarë të Siguruarit shumën maksimale e pagueshme sipas kësaj police në lidhje me çdo ngjarje ose çdo shumë më të vogël me të cilën mund të rregullohen pretendimet që lindin nga një ngjarje e tillë, dhe Siguruesi nuk do të ketë përgjegjësi të mëvonëshme në lidhje me atë ngjarje, me përjashtim të pagesës së kostos dhe shpenzimeve të mosmarëveshjeve të shkaktuara për pagesa të tilla.
- Nëse në kohën e ndonjë ngjarje ose pretendimi për dëmshpërblim, ekziston një policë tjetër për dëmshpërblim ose sigurim në favor të/ose e ndikuar nga/ose në emër të Siguruarit, e zbatueshme në të tilla ngjarje, Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës sipas kësaj police të dëmshpërblejë të Siguruarin në lidhje me këtë ngjarje ose pretendim, me përjashtim të pjesës që tejkalon shumën e cila do të ishte e pagueshme sipas dëmshpërblimit ose sigurimit tjetër sikur kjo police të mos ishte në fuqi.

Kushte të Përgjithëshme

- Kjo police, shtojcat e poshtëshënuara, formulari dhe kushtet specifike do të lexohen së bashku si një kontratë, dhe çdo fjalë ose shprehje për të cilën është atribuar një kuptim i vecantë në çdo pjesë të kësaj police, formularit ose kushteve të vecanta, do të mbajë po atë kuptim kudo që të shfaqet.
- Nëse primi për këtë police ka qënë kalkuluar sipas një vlerësimi të dhënë nga i Siguruarit, ky do të mbajë shënimin të sakta për gjithë detajet përkatës dhe do të lejojë Siguruesin në çdo moment të arësyeshëm të kohës të inspektogjë shënimin të tilla dhe me mbarimin e çdo periudhe dëmshpërblimi, do ti dërgogjë Siguruesit gjëndjen e saktë të rregulluar kështu që për këtë periudhë do të kalkulohet primi dhe diferenca e paguar nga i Siguruarit si mbulim.
- Siguruesi mundet në çdo kohë të arësyeshëm të inspektogjë çdo njësi dhe në rast të ndonjë difekti ose rreziku të paraqitur, Siguruesi mund të japë njoftim me shkrim të Siguruarit për rastet kur e gjithë përgjegjësia e siguruarit për arsye të difekteve dhe rreziqeve të tilla, do të pezullohet.
- Nëse në një kohë të caktuar do të shfaqet materialisht dicka që do të ndikogjë në rrezikun e siguruarit, i Siguruarit duhet, brenda 7 ditëve të japë njoftim me shkrim Siguruesit.
- Vëzhgimi dhe plotësimi i detyrueshëm i kushteve, klauzolave e parashikimeve përsa ato lidhen me ndonjë gjë që duhet kryer ose plotësuar nga i Siguruarit dhe vërtëtesia e pohimeve të bëra prej tij në kërkesën për sigurim (e cila duhet të jetë baza e kësaj kontrate) do të jenë kushte parësore për përgjegjësi të Siguruesit.
- Ne rast se mosmarëveshjet midis paleve nuk zgjidhen me mirëkuptim, atehere do të zgjidhen nga Gjykata e vëndit ku është lëshuar Polica e Sigurimit.